



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 60/51 Prot.

Tiranë më 21.11.2024

V E N D I M
Nr. 57, datë 21.11.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Henri Naqellari	Kryesues
Loreta Hanxhari	Relatore
Bora Vrenjo	Anëtare

asistuar nga sekretarja e Sekretariatit Teknik, Znj. Ersila Kalaja, në datën 07.11.2024, ora 11:00, në Sallën e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Lorenc Lulzim Meta, me funksion aktual Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj. Loreta Hanxhari, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar (në vijim Ligji 12/2018, i ndryshuar).

2. Bazuar në Nenin 6 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, shtetasi *Lorenc Meta* është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit që mbante në momentin e hedhjes së shortit si *Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës dhe aktualisht si Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë.*

3. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, më datë 05.04.2022 ka shortuar Trupën Vlerësuese dhe më datë 04.07.2023 ka shortuar relatorin e çështjes për subjektin e vlerësimit *Z. Lorenc Meta* për t’ju nënshtruar procesit të vlerësimit kalimtar, bazuar në dispozitat e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07 datë 17.01.2023 “*Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit 12/2018, i ndryshuar*”, të përbërë nga Relatore Znj. Loreta Hanxhari, Kryesues Z. Henri Naqellari dhe Anëtare Znj. Bora Vrenjo.

4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, më datën 02/08/2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit sipas nenit 27, pika 1 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.

5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin 12/2018, të ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 dt.28.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, me Vendimin nr.1 datë 02.08.2023 vendosi:

- *Të fillojë hetimi kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Lorenc Meta me funksion Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës.*
- *Të njoftojë me shkrim subjektin e vlerësimit për fillimin e hetimit.*
- *Të bëhet njohja e subjektit të vlerësimit me përbërjen e trupës së vlerësimit për të drejtën e deklaramit të konfliktit të interesit të subjektit me trupën.*

6. Bazuar në nenin 49 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit *Lorenc Meta* në datën 02.08.2023 është njoftuar në adresën elektronike zyrtare të tij, për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, është njohur me përbërjen e Trupës së Vlerësimit, dhe i është kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit sa më sipër.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, “Deklaratën për Konfliktin e Interesit” me nr. ** prot. datë 15.08.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

8. Relatori i çështjes në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:

- nenit 7, pika 1 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, nenit 4 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 04.08.2023, pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit .
- nenit 7, pika 7 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 04.08.2023, pranë DPPSH-së, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
- nenit 7, pika 4 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 04.08.2023, pranë AMP-së, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.

9. Bazuar në nenin 34, pika 3, nenin 42, pika 1 dhe nenin 46, pika 2 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (në vijim AMP) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim DPPSH). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

10. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të Nenit 25, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

11. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

12. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në Nenin 4, të Ligjit nr.12/2018 (*i ndryshuar*) ka për objekt:

a) *vlerësimin e pasurisë;*

b) kontrollin e figurës;

c) vlerësimin e aftësive profesionale.

13. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a) Ligjin 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b) Ligjin nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.
- c) Ligjin nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”.
- d) Ligjin nr. 49/2012 “ Për Gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”.
- e) Ligjin nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”.
- f) Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr.07 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
- g) Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.06, datë 17.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Kontrollit të Figurës dhe Vlerësimit të Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik, si dhe mënyrën e plotësimit të tyre në zbatim të Ligjit nr.12/2018 të ndryshuar.
- h) Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15 datë 27.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme’ i ndryshuar.
- i) Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

Gjithashtu trupa e vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- *Deklarata e Pasurisë,*
- *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
- *Formulari i Vlerësimit Profesional*
- *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklarimet,*
- *Tri raportet ndihmëse të hartuara nga institucionet shtetërore;*
- *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.*
- *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.*
- *Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3 pika 12 dhe 14 të ligjit 12/2018 të ndryshuar, nenit 3, pika 11 dhe nenit 5 të

Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

15. Trupa e vlerësimit, pasi dëgjoi relatimin e bërë nga relatorja e çështjes dhe studioi materialin e përgatitur për këtë qëllim, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatuan se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Lorenc Meta, me Vendimin nr.2, datë 28.10.2024, vendosi:

- a) Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Lorenc Meta;
- b) Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht dhe*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
- c) Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

16. Me subjektin e vlerësimit, është komunikuar me anë të postës elektronike duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave.

17. Subjekti i vlerësimit, pas dërgimit të relacionit paraprak dhe njoftimit me e-mail datë 28.10.2024, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Trupa Vlerësuese, e ushtroi të drejtën e njohjes me dosjen por nuk paraqiti parashtrime.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i vlerësimit Lorenc Meta u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me e-mail, në datën 05.11.2024, ku dhe u njoftua se seanca publike dëgjimore është përcaktuar për t’u mbajtur në datën 07.11.2024, ora 11:00, në adresën: Salla e Mbledhjeve Kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme.

19. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën dhe adresën e përcaktuar.

20. Subjekti i vlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i vlerësimit Lorenc Meta kërkoi nga Trupa Vlerësuese konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

21. Z. Lorenc Meta ka qenë bashkëpunues në procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe gjatë

gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Trupa Vlerësuese, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Në bazë të nenit 32, pika 1, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, punonjësi deklaron çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.
23. Trupa e Vlerësimit ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe fakt, për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësin dhe për personat e lidhur me të, të parashikuar në nenin 31, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
24. Deklarimi i pasurisë nga subjekti kryhet sipas parashikimeve të nenit 32 e 33, ndërsa procedura e vlerësimit të pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të Ligjit 12/2018 të ndryshuar.
25. Sipas kreut III, neni 33/1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI-ja bazuar në deklaratimet e pasurisë, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli dhe në përfundim përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.
26. Hetimi administrativ i Trupës Vlerësuese pasi administroi dhe u njoh me Raportin e ILDKPKI-së, konsistoi në:
- *verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;*
 - *në verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të deklaruara;*
 - *në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;*
 - *në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.*
27. Trupa e Vlerësimit për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë, ka thelluar hetimin nëpërmjet:
- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së pasurisë së vlerësimit kalimtar;
 - b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhat përkatëse, në raport me të dhënat në deklaratën e vlerësimit kalimtar;

- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje cash;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar.

28. Trupa e Vlerësimit i ka vlerësuar këto deklaratime së bashku me provat e tjera në tërësi dhe harmoni me të gjitha rrethanat e çështjes.

29. Subjekti i vlerësimit Z. Lorenc Meta ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion justifikues për të justifikuar vërtetësinë e deklaratimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në zbatim të nenit 32, pika 2 të ligjit nr.12/2018, i ndyshuar.

30. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33/1, pika 3 e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

DEKLARIMI I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT

1. Apartament me sipërfaqe 122.5 m2, ndodhur në Tiranë me adresë Farkë, Selitë, Rr. "Kodra e Diellit", P. xx, H. xx, AP. xx. Blerë në vitin 2006, me kontratë shitje paraprake në emër të familjes, datë 03.10.2006 dhe hipotekuar në vitin 2012, ku ka kaluar në emrin tim. Burimi i të ardhurave ka qenë nga lekët e fituara nga aktiviteti i vreshtarisë që nga viti 1994 deri në vitin 2006, ku fitimi ka qenë 600.000 lekë të reja në cdo vit, kursimet familjare në vite dhe puna e kryer nga familja në emigracion. Vlera 50.420 euro. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje paraprake datë 03.10.2006, Për apartamentin 2+1, me nr. xx, hyrja xx, Kulla 2, me sipërfaqe ndërtimore 132.70 m2, me cmim 380 Euro/m2 ndërtuar nga shoqëria ndërtuese "Anresl Konstruksion ", me palë e parë (shitësi) B. B. dhe palë e dytë (blerësi) Lulzim Meta, me vlerë 50.426 euro. Pagesa është kryer totalisht nga blerësi, ditën e lidhjes së kontratës.
- Planimetria e apartamentit.
- Kontratë shitje (pasuri e paluajtshme) me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 23.03.2012, për apartamentin me sipërfaqe 122.50 m2, nr. x, shkalla x, kati x teknik, ndodhur pranë Kopshtit Botanik, Selitë Tiranë, regjistruar në ZRPP, me nr. pasurie **, zk. 3292 në datë 09.02.2012, me palë e parë (shitëse): B. B., M. B., K. B. dhe palë e dytë (blerëse) Lorenc Meta. Cmimi i shitjes 452, 14 euro/m2. Palët deklarojnë se likuidimet i kanë bërë dhe nuk kanë asnjë detyrim ndaj njëri - tjetrit. Pala shitëse i dorëzon palës blerëse apartamentin, të lirë nga cdo barrë hipoteke dhe pala blerëse i ka dorëzuar palës shitëse, shumën e mësipërme.

- Certifikatë për vërtetim pronësie me nr. **, datë 09.04.2012, nga Zyra e Regjistrimit Tiranë, për apartament banimi me sip. 122.5 m², nr. pasurie **, zk. 3292, vol. **, faqe **, me adresë Selitë Tiranë, në pronësi të B. B., M. B. dhe K. B.. Bashkëlidhur: Kartelë e pasurisë së paluajtshme dhe planimetria e apartamentit.
- Certifikatë për vërtetim pronësie me nr. **, datë 09.04.2012, nga Zyra e Regjistrimit Tiranë, për apartament banimi me sip. 122.5 m², nr. pasurie **, zk. 3292, vol. **, faqe **, me adresë Selitë, Tiranë, në pronësi të Lorenc Meta.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1.1 ASHK - Drejtoritë Vendore: Tirana Jug, Zonat e Stimuluara, Tirana Rurale 2. Tirana Rurale 1 Tirana Veri me shkresat me nr. ** prot., datë 09.10.2023, datë 12.10.2023, datë 23.11.2023 dhe datë 30.10.2023, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emrin e Lorenc Meta dhe familjarëve të tij.

1.2 ISSH me shkresë me nr. ** prot., datë 06.09.2023, konfirmon se Lulzim Meta nga muaji shkurt 2022, përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale 10.068 lekë. Dylbere Meta nga muaji tetor 2013, përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale 17.972 lekë.

1.3 ISSH, Drejtoria e Arkivit Qëndror, me shkresën kthim përgjigje me nr. ** prot., datë 12.09.2023, nuk konfirmon të dhëna për periudhën 1994 - 2012, për shtetasin Lorenc Meta dhe familjarët e tij. Bashkëlidhur dokumentacioni si vijon:

- Vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni, me nr. ** prot., datë 07.09.2023, që konfirmon se shtetasi Lulzim Zeqir Meta, lindur më 1954 në Burrel, figuron:
 - në Rajonin Durrës dhe ka punuar në N.B. Mamurras, Ishëm, për periudhën nga 02.12.1987
 - në Rajonin Lezhë dhe ka punuar në ndërtim, Mamurras, për periudhën nga 10.07.1969 - 06.10.1972; Në N.B. Thumanë, Mamurras, për periudhën nga 17.01.1977 - 01.05.1977;
 - në Rajonin Lezhë dhe ka punuar: Në N.B.SH., Thumanë, për periudhën nga 17. 01.1977 - 01.05.1977; Në Stac.Hek. Lac, për periudhën nga 13.05.1977-13.07.1979; Në Rep. Usht. 6136, Lac, për periudhën nga 13.07.1978 - 01.02.1979; Në N.N. Hekurudha, Lezhë, për periudhën nga 24.08.1979 - 06.09.1979; Në K. SH. T. Hekurudha, Lac, për periudhën nga 07.09.1979 - 30.03.1981; Në Parkun e Mallrave, Lac, për periudhën nga 15.04.1981; Në Parku i Mallrave, Lac, për periudhën nga 03.01.1986 - 15.11.1996;
 - në Rajonin Lezhë dhe ka punuar: Në N.B. Sek. Frutikulturë, për periudhën nga 24.01.1985;
 - në Rajonin Lezhë dhe ka punuar në N.B. Thumanë, Frutikulturë, për periudhën nga 20.08.1989;
 - në Rajonin Durrës dhe ka punuar në N.B. Mamurras, Sek. Ishëm, për periudhën nga 05.03.1976- 14.01.1977;
- Vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni, me nr.** prot., datë 07.09.2023, që konfirmon se shtetasja Dylbere Xhafer Meta, lindur më 21.10.1953 në Krujë, figuron:
 - në Rajonin Lezhë dhe ka punuar në N.B. Sekt. F. Kulturës, Mamurras, për periudhën 20.01.1987;
 - në Rajonin Lezhë dhe ka punuar në Ndërmarrja Ndërtimi, Krujë, për periudhën nga 16.06.1973; Në N.N.I. Kantjeri Qendër, Lac, për periudhën nga 24.03.1977 - 01.03.1978;

Në N.N.I. Kantjeri, Krujë, për periudhën nga 02.03.1978 -17.04.1979; Në N.N.I. Kantjeri Qendër, Lac, për periudhën nga 17.04.1979 -18.01.1987;

- në Rajonin Lezhë dhe ka punuar në: N.N. Lac Kant., Qendër Lac, për periudhën nga 24.03.1977 - 01.03.1978; Në N.N.I. Krujë, për periudhën nga 02.03.1978 - 17.04.1979; Në N.N.I. Kant. Qendër, Lac, për periudhën nga 17.04.1979 - 18.01.1987; Në N.B. Sek. Frutikulturë, Mamurras, për periudhën nga 20.01. 1987 - 19.09.1992; Në Zyrën e Punës Perk. Soc., Lac, për periudhën nga 20.09.1992 - 05.12.1992; Në N.B. Frutore 1, Mamurras, për periudhën nga 05.12.1992;
- në Rajonin Durrës dhe ka punuar: Në Nd. Ndërtim, Mamurras, për periudhën nga 16.06.1973; Në N.N.I. Lac Kant., Qendër, për periudhën nga 24.03.1977-01.02.1978; Në N.N.I. Kant. Krujë, për periudhën nga 02.03.1978.

1.4 Në procesverbalin e datës 13.02.2024, subjekti sqaroi se apartamenti me sip. 122.50 m² i ndodhur pranë Kopshtit Botanik, Selitë, Tiranë, me vullnetin e lirë të prindërve është kaluar në pronësinë e tij dhe për shkak të njohjes që babai Lulzim Meta kishte me shitësit e këtij apartamenti, të cilët ishin pronarë të truallit, ku ishte ndërtuar pallati, kërkoi që kontrata e shitblerjes përfundimtare e vitit 2012 të bëhej në emrin e Lorenc Meta. Për shkak të marrëdhënieve familjare nuk kanë nënshkruar deklaratë noteriale apo kontratë dhurimi në atë periudhë me babain Lulzim Meta, për apartamentin me adresë Kopshti Botanik, Selitë, Tiranë. Ky apartament është blerë në vlerën 50.426 euro, vlerë e cila është pasqyruar në kontratën e shitjes paraprake datë 03.10.2006 dhe pagesa është bërë cash nga babai Lulzim Meta ndaj (individëve), shitësve të këtij apartamenti (pronar të truallit), në zyrat e Shoqërisë "Anresl Konstruksion ", pasi pallati ndërtohej nga kjo shoqëri.

1.5 Lidhur me deklarinimin e vlerës së këtij apartamenti prej 54.000 euro në deklaratat e interesave privatë ndër vite, deklaroi se është lapsus në shkrim dhe konkretisht vlera në shifra nga 50.426 euro është pasqyruar në 54.000 euro, pasi ka zhvendosur gabim . numrin 4 (katër). Ndryshimi sipërfaqes së këtij apartamenti, e cila, sipas kontratës së shitjes (pasuri e paluajtshme) datë 23.03.2012, është 122.50 m², ndërsa sipas kontratës paraprake datë 03.10.2006, është 132.7 m², ka ndodhur pasi në kontratën paraprake janë përfshirë edhe sipërfaqet e ambjenteve të përbashkëta, si sipërfaqe shkalle, sipërfaqe ashensori etj. Ndryshimi në rritje i vlerës së këtij apartamenti në euro për m², e pasqyruar në kontratën e shitjes përfundimtare të vitit 2012 është pasi, kur është bërë hipotekimi i pallatit ku ndodhet apartamenti, cmimi i referencës së apartamenteve në vitin 2012 kishte ndryshuar nga viti 2006 dhe sistemi i hipotekës në ZVRPP Tiranë nuk pranonte cmimin real të blerjes së apartamentit në vitin 2006 nga babai Lulzim Meta. Si rrjedhojë në kontratën e shitblerjes përfundimtare të vitit 2012 është vendosur cmimi i referencës që kishte kjo zonë, në shumën 452.14 euro/ m² dhe është pasqyruar si cmim i këtij apartamenti në kontratën e shitblerjes përfundimtare të nënshkruar nga subjekti. Deklaroj se për këtë apartament nuk është bërë asnjë pagesë shtesë pas pagesës se kryer nga babai i subjektit në vitin 2006 për kalimin e apartamentit nga shitësi në emrin e Lorenc Meta.

1.6 Burimi i krijimit për blerjen e këtij apartamenti janë kryesisht të ardhurat e siguruara nga familja nga viti 1994 në Mamurras nga prodhimet e vreshtarisë. Për tokat me sip. totale 13.300 m², të dhuruara nga prindërit ka bashkëlidhur: certifikatë pronësie për tokën vreshtë me sip. 8300 m², AMTP për tokën vreshtë me sip. 5000 m², si dhe akte noteriale të dhurimit që konfirmojnë se prindërit i'a kanë lënë subjektit në trashëgim. Toka vreshtë me sip 5000 m², nuk është e regjistruar në ASHK Drejtoria Vendore Kurbin, pasi kjo zonë nuk është azhornuar. Këto sipërfaqe toke vresht, nuk janë mbjellë nga familja, por

ishin të mbjella me vreshtë nga ndërmarrjet bujqësore para viteve 1990 dhe ishte në prodhim e gjithë sipërfaqja e tokës. Për të ardhurat nga prodhimet e vreshtarisë, ka siguruar vërtetimet nga Agjencia Rajonale e Ekstencionit Bujqësor Shkodër, Sektori i Ekstencionit Bujqësor Lezhë, për prodhimet bujqësore të fermerit Lorenc Meta, nga viti 2000 e në vijim dhe fermerit Lulzim Meta, nga viti 1995 - 2000 e në vijim, me adresë Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Mamurras, si dhe akt-vlerësimi nga agronom i miratuar, që ka vlerësuar të ardhurat nga vreshtaria për periudhën e viteve 1994 - 2022. Pavarësisht se nga akti i vlerësimit të ardhurat nga vreshtaria rezultojnë rreth 55.040.000 lekë, akti vlerësimit është një parashikim i ekspertit mbi të ardhurat e krijuara në kushte optimale. Të ardhurat e përfituara nga veprimtaria e vreshtarisë e fermerit kanë qenë mesatarisht 600.000 lekë në vit, duke filluar nga viti 1994 deri aktualisht, pasi ishin hequr shpenzimet për mirëmbajtjen e vreshtarisë, për shkak të faktorëve të ndryshëm, si shira, thatësira, dëmtime të ndryshme nga insektet, por edhe shpenzimet që janë dashur për spërkatjen, plehërimin etj., të vreshtarisë dhe nuk kishin mundësi që të krijonin të ardhurat sipas parashikimeve të ekspertit. Të ardhurat nga vreshtaria për periudhën e viteve 1994 - 2006 kanë qenë në total rreth 7.200.000 lekë, nga të cilat familja kishte krijuar kursimet me të cilat është blerë apartamenti i sipërcituar. Nuk dispononte fatura të shitjes së prodhimeve të vreshtarisë nga viti 1994 e në vijim, pasi këto prodhime janë shitur nga prindërit e tij në tregun e lirë të fruta perimeve. Në lidhje me prodhimet e vreshtarisë, të njëjtin vlerësim konfirmon edhe Agjencia Rajonale e Ekstencionit Bujqësor Shkodër, Sektori i Ekstencionit Bujqësor Lezhë, sipas së cilës prodhimi i kësaj vreshtarie në atë zonë është 180-200 kv/ha.

1.7 Sqaroi se nuk është i pajisur me NIPT Fermeri, por vetëm i pajisur me kartën e fermerit nga Agjencia Rajonale e Ekstencionit Bujqësor Shkodër, Sektori i Ekstencionit Bujqësor Lezhë, pasi nuk është domosdoshmërisht e nevojshme pajisja me NIPT e një aktiviteti si shitja e prodhimeve të vreshtarisë (rrush). Në bazë të legjislacionit që rregullon veprimtarinë e fermerëve, duke mos qenë i pajisur me NIPT, nuk ka pasur detyrim ligjor për shlyerjen e detyrimeve tatimore, ashtu sikurse nuk ka të drejtë për kompensimet ligjore si fermer, si kompensimi me naftë, pesticide etj. Në Ligjin nr. 92, nenet 145, 146, 147, 148 të vitit 2014 "Për TVSH" nga Ministria e Financave, si dhe Udhëzimi nr. 19, datë 03.11.2014, nga Ministria e Financave, për kompensimin e fermerëve (i ndryshuar), shprehet qartë kur ka të drejtë fermeri të përfitojë nga TVSH, kompensim të cilin subjekti nuk e ka përfituar asnjëherë, pasi nuk ka aplikuar për këtë lloj përfitimi. Pra duke mos qenë i regjistruar me NIPT Fermeri, nuk ka shlyer detyrime tatimore mbi të ardhurat nga vreshtaria, pasi nuk është subjekt i tatimeve. Të ardhurat nga prodhimet e vreshtarisë (rrush) nga viti 1994 deri aktualisht janë bërë nga prindërit e subjektit në tregun e lirë të fruta - perimeve, Lac, Milot dhe Fushë - Krujë, ndërsa puna e tij, ishte në mirëmbajtjen e tokave gjatë disa periudhave të vitit, kur kishte ditë pushimi.

1.8 Sqaroi se aktivitetin e vreshtarisë e ka pasion dhe e ka ushtruar nga viti 1994 në ndihmë të familjes së tij bujqësore, e në vazhdim, dhe e kryen dhe sot. Aktiviteti i fermerit nuk bie ndesh me punën e tij në Policinë e Shtetit, pasi puna me vreshtarinë nuk ka çenuar kryerjen e detyrave në Policinë e Shtetit dhe këtë veprimtari e kryen në periudha të ndryshme fundjavash, ditë pushimi, leje të zakonshme, etj. Kjo veprimtari nuk krijon përplasje interesash me asnjë nga pozicionet që ka pasur apo vazhdon të ketë në Policinë e Shtetit. Vlera e të ardhurave vjetore të përfituara nga puna në Policinë e Shtetit bashkë

me të ardhurat nga prodhimet bujqësore nuk kalojnë vlerën 2.000.000 lekë dhe, si rrjedhojë, nuk ka pasur detyrim për plotësimin e deklarimit DIVA.

1.9 Subjektit i është kërkuar nga Trupa vlerësuese, të paraqesi dokumentacion ligjor justifikues përkatës mbi pagesën e taksës së tokës për gjithë periudhën që pretendon se e ka shfrytëzuar këtë sipërfaqe toke (vreshtë). Ai në shkresën kthim përgjigje nr. ** prot. datë 08.07.2024, ka paraqitur vërtetimet datë 03.07.2024 nga Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Mamurras, ku vërtetohet se Lorenc Meta, Lulzim dhe Dylbere Meta kanë shlyer detyrimet e taksës së tokës për të gjitha vitet deri në vitin 2024.

1.10 Gjithashtu subjektit i është kërkuar të vërë në dispozicion të Trupës, kartën e fermerit, por në kthim përgjigjet e tij është shprehur se nuk e dispononte fizikisht. Trupa vlerësuese i është drejtuar AREB Shkodër, institucion i cili me shkresë nr. ** prot., datë 08.10.2024, n aka bërë me dije se Lorenc Meta është fermer nga viti 2000 e në vijim, i regjistruar në regjistrin e fermës dhe i pajisur me kartë fermeri AL-180xxxxxx115 (bashkëngjitur Regjistri i Fermës).

1.11 Lidhur me burimin e të ardhurave nga puna në emigracion të babait Lulzim Meta, sqaroi se babai ka qenë emigrant në Greqi, në periudha të ndryshme në vitet 1993 -1994 dhe 1996 - 1997, pa dokumenta të rregullta dhe pa leje qëndrimi dhe ka punuar në punë të ndryshme pa kontrata pune. Me të ardhurat që babai i ka siguruar nga puna në emigracion, kanë mbuluar shpenzimet e jetesës. Të ardhurat e babait nga puna në emigracion ishin rreth 2.200.000 lekë dhe janë sjellë dorazi. Në lidhje me të ardhurat nga puna e babait në emigracion në Greqi, në vitet 1993 - 1994 dhe 1996 _1997, sqaroi se nuk disponon dhe nuk mund të sigurojë dokumentacion justifikues. Në kohën që babai i tij ka qenë në emigracion, puna në vreshtari ka vazhduar nga pjesëtarët e tjerë të familjes.

1.12 Për blerjen e apartamentit, subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë financuar me të ardhurat nga pagat, por këto të ardhura janë përdorur në mbështetje financiare për të mbuluar shpenzimet familjare në ato vite, si dhe mobilimin e apartamentit me adresë pranë Kopshtit Botanik Tiranë.

1.13 Për mobilimin e këtij apartamenti sqaroi se është bërë në vitet 2008 - 2009 dhe është mobilim modest me të gjitha paisjet që duhen në një familje normale. Në këtë apartament kanë filluar të jetojnë nga muaji Tetor 2009, kohë në të cilën subjekti është transferuar me punë në Tiranë. Nga viti 2002 deri në vitin 2009, kur filloi të banojë në apartament, me kursimet e tija dhe të bashkëshortes nga pagat, por edhe nga fitimet e prodhimeve të vreshtarisë, kanë mobiluar apartamentin me guzhinë gatimi, së bashku me elektroshhtëpiaket: televizor, lavatrice, dy kondicioner, set divanësh në sallon, së bashku me tavolinë ngrënie, dhomë gjumi çifti dhe dhomë gjumi për fëmijët. Ky mobilim është i plotë dhe shuma e shpenzuar e përlogaritur nga subjekti është në vlerën rreth 477.000 lekë (televizor 45.000 lekë, lavatrice 32.000 lekë, guzhina e gatimit 150.000 lekë, dy kondicionerë 60.000 lekë, divanë+tavolinë 80.000 lekë, dhomë gjumi 60.000 lekë dhomë gjumi 50.000 lekë). Nuk dispononte fatura blerjesh për mobilimin e apartamentit, pasi nuk ka ruajtur këto dokumenta, pasi ka kaluar shumë kohë, mobilimi është shtrirë në vite dhe blerjet janë bërë në dyqane të ndryshme.

1.14 Deri në muajin tetor të vitit 2009, duke qenë se është djalë i vetëm, së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët, kanë jetuar në shtëpinë e prindërve në Mamurras, Kurbin dhe në muajin tetor 2009 kanë filluar të jetojnë në apartamentin në Tiranë. Në Policinë e Shtetit ka filluar punë në datë 16.08.2002 dhe për periudhën nga muaji gusht 2002 deri në muajin mars 2023 ka punuar në të gjitha Drejtoritë e Policisë. Gjatë kësaj periudhe, ka banuar në ambjentet që ofronin Drejtoritë e Policisë në qarqe. Vetëm në rastet kur ka punuar në Drejtoritë e Policisë në Qarqet Tiranë, Durrës, Berat, Lezhë dhe Elbasan, ka jetuar pranë familjes në apartamentin në Tiranë, pasi e bënte rrugën vajtje - ardhje brenda ditës. Paraqiti:

- Vërtetim me nr. ** prot., datë 16.01.2024, nga Agjencia Rajonale e Ekstencionit Bujqësor Shkodër, Sektori i Ekstencionit Bujqësor Lezhë, ku vërtetohet se fermeri Lorenc Meta me aktivitet në Bashkinë Kurbin, Njësia Administrative Mamurras, ushtron aktivitetin si fermer nga viti 2000 e në vijim, në veprimtarinë Bujqësi, Vreshtari - 180-200 kv/ha;
- Vërtetim me nr. ** prot., datë 16.01.2024, nga Agjencia Rajonale e Ekstencionit Bujqësor Shkodër, Sektori i Ekstencionit Bujqësor Lezhë, ku vërtetohet se fermeri Lulzim Meta me aktivitet në Bashkinë Kurbin, Njësia Administrative Mamurras, ushtron aktivitetin si fermer nga viti 1995 - 2000 e në vijim, në veprimtarinë Bujqësi, Vreshtari: 180 - 200 kv/h.
- Akt-vlerësimi "Mbi prodhimin e një sipërfaqe vreshti", datë 19.01.2024 nga Z. P. K., agronom i miratuar nga QKL, me LA-5531-xx-2012, numër NIPTI KxxxH, ku pasqyrohet se: Qytetari Lorenc Lulzim Meta posedon një sipërfaqe të mbjellë me vreshtë me varietetet muskat Italian, prej 13.3 dynym, ku,
- Vlerëson se në periudhën 1994 — 2000 ka marrë një prodhim rreth 12 kuintal Për dynym, e barabartë me 160 kuintal rrush në vit, për të gjithë sipërfaqen e mbjellë. Cmimi i referencës i asaj periudhe ka qenë rreth 6500 lekë për kuintal. Të ardhurat totale të nxjerra në një vit nga kjo sipërfaqe vreshte janë 1.040.000 lekë, ndërsa për 6 vite x 1.040.000, barabartë me 6.240.000 lekë;
- Vlerëson se në periudhën e viteve 2000 - 2010 ka marrë një prodhim rreth 15 kuintalë për dynym, e barabartë me 200 kuintal rrush në vit, për të gjithë sipërfaqen e mbjellë. Cmimi referencës i asaj periudhe ka qenë rreth 10.000 lekë për kuintal. Të ardhurat totale të nxjerrë në një vit prodhimi nga kjo sipërfaqe vreshti 15 kuintal x 13.3 dynym x 10.000 e barabartë me 2.000.000 lekë, ndërsa për dhjetë vite 20.000.000 lekë.
- Vlerëson se në periudhën e viteve 2010 - 2022 ka marrë një prodhim rreth 15 kuintalë për dynym, e barabartë me 160 kuintal rrush. Cmimi referencë i asaj periudhe ka qenë rreth 12.000 lekë per kuintal. Të ardhurat totale të nxjerra në një vit prodhimi nga kjo sipërfaqe vreshti 15 kuintal x 13.3 dynym x 12.000 lekë e barabartë me 2.400.000 lekë në vit. Ndërsa Për 12 vite 12 x 2.400.000 e barabartë me 28.800.000 lekë. Të ardhurat totale të nxjerra nga kjo sipërfaqe e mbjellë me vreshtë, për periudhën 1994 - 2022 është e barabartë me 55.040.000 lekë.

Bashkëlidhur:

- Licencë nga QKL për subjektin Pjetër Korriku me IN-5531-xx-2012, numër NIPTI KxxxH;
- Foto te tokës me vreshtari (në pronësi të subjektit);
- Foto të tokës ullishte (në pronësi të prindërve të subjektit);
- Ligji nr. 92, për nenet 145, 146, 147, 148, të vitit 2014, Për TVSH nga Ministria e Financave, si dhe Udhëzimi nr. 19, datë 03.11.2014, nga Ministria, për të drejtën e kompensimit të fermerëve (i ndryshuar) me TVSH.

1.15 Në proces verbalin e datës 26.02.2024. subjekti sqaroi se në kartelën e pasurisë vlera e apartamentit është shkruajtur gabim nga punonjësi i ZVRPP Tiranë, 45214 euro, pa i vënë pikë ndarje, që gjithsesi është cmimi euro/m². Sipas kontratës së shitjes përfundimtare datë 23.03.2012, apartamenti me sip. 122.5 m² ka vlerë 452, 14 euro/m² që do të thotë se vlera e këtij apartamenti, sipas kësaj kontrate, rezulton 122.5 m² x 452, 14 euro/ m² e barabartë me 55.387 euro. Ai ka sqaruar edhe më parë, duke deklaruar në përgjegjësi personale, se në kontratën e shitjes përfundimtare të nënshkruar nga subjekti, në datë 23.03.2012 është pasqyruar vlera 452.14 euro/m², pasi kur është bërë hipotekimi i pallatit, ku ndodhet edhe apartamenti, në vitin 2012 cmimi i referencës së apartamenteve kishte ndryshuar nga viti 2006 dhe sistemi i hipotekës në ZVRPP Tiranë, nuk pranonte cmimin real të blerjes së apartamentit në vitin 2006 nga babai i subjektit. Për këtë apartament, nuk është bërë asnjë pagesë shtesë përveç pagesës së kryer nga babai Lulzim Meta, në vitin 2006, në shumën 50.420 euro, cituar edhe në kontratën paraprake datë 03.10.2006, që vërteton se vlera e blerjes prej 50.420 euro është likuaduar brenda asaj dite. Paraqiti:

- Kartelë pasurie e paluajtshme për apartamentin me sipërfaqe 122.50 m², në Selitë Tiranë, me nr. pasurie **, zk. 3292, datë 11.04.2012, në pronësi të Lorenc Lulzim Meta, ku pasqyrohet cmimi 45214 euro.

1.16 Bazuar në deklarinimin e subjektit dhe dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton: Apartamenti i banimit me sip. 122.5 m², me adresë pranë Kopshtit Botanik, Selitë Tiranë, është përfituar në vitin 2006, me kontratë porosie nga babai i subjektit, likuiduar në vlerën 50.426 euro, me burim kursime nga të ardhurat familjare nga prodhimet bujqësore (vreshtari) nga viti 1994 deri në vitin 2006, për të cilat ka paraqitur dokumentacion të pjesshëm justifikues, si dhe të ardhurat nga puna në emigracion e babait, për periudhën e viteve 1993 - 1994 dhe 1996 - 1997, për të cilat nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues. Kontrata përfundimtare e shitblerjes është bërë në v. 2012 në emrin e subjektit.

Konstatohet:

- ✓ **Mungesë dokumentacioni financiar lidhur me të ardhurat e përfituara nga prodhimet e vreshtarisë për periudhën 1994 - 2006, nga toka me sip. 13.300 m² (trajtuar më poshtë), përfituar me AMTP me adresë Fshati Mamurras, Kurbin, në shumën 7.200.000 lekë, si dhe të ardhurat e përfituara nga puna në emigracion e babait për periudhën e viteve 1993 - 1994 dhe 1996 - 1997, në shumën 2.200.000 lekë, përdorur si burim financiar për blerjen e apartamentit me sip. 122.5 m² në Tiranë në vlerën 50.420 euro në vitin 2006 për të cilat është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1 e ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit. Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Cështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar.**
- ✓ **Shpenzimet për arredimin e apartamentit me sip. 122.5 m² janë deklaruar rreth 477.000 lekë.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me cmimin e blerjes së apartamentit, i cili sipas kontratës së shitjes paraprake është 50.420 Euro, ndërsa sipas kontratës përfundimtare të shitjes është 452.14 Euro/m², llogaritur në vlerën 55.387 Euro.**

2. Vreshtë me sipërfaqe 8300 m2, përfituar me Ligjin 7501, nr. prone **, zona kadastrale 1676, e regjistruar ZVRPP Lac. Vlera 0. Zotëron 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë dhurimi pasurie të paluajtshme, me nr. ** rep., nr. ** kol., datë 20.04.2018, për pasurinë e paluajtshme me nr. **, përshkruar në Certifikatën për Vërtetim Pronësie, me nr. **, lloji vreshtë, e ndodhur në zk. 1676, volumi **, faqe **, me adresë në Mamurras, me sipërfaqe totale 8300 m2, me palë dhuruese z. Lulzim Meta, znj. Dylbere Meta dhe palë pranuese e dhurimit z. Lorenc Meta. Referuar shënimit F, në kartelën e përditësuar të pasurisë së paluajtshme objekt kontrate, prona ka origjinën nga familja bujqësore dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, bashkëpronarë në masë të barabartë të kësaj prone janë anëtarët e përbërjes familjare aktuale të kryetarit të familjes bujqësore, z. Lulzim Meta. Në bazë të certifikates familjare të nxjerrë nga sistemi e - Albania, anëtarët e saj janë: z. Lulzim Meta dhe bashkëshortja znj. Dylbere Meta.
- Certifikatë për vërtetim pronësie me nr. **, datë 28.02.2015 nga ZVRPP Lac, për tokë vreshtë me sip. 8300 m2, nr. pasurie **, zk. 1676, vol. **, faqe **, me adresë Mamurras, në pronësi të Lulzim Meta.
- Certifikatë për vërtetim pronësie me nr. **, datë 24.04.2018, nga ZVRPP Lac, për tokë vreshtë me sip. 8300 m2, nr. pasurie **, zk. 1676, vol. **, faqe **, me adresë Mamurras, në pronësi të Lorenc Meta.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

2.1.ASHK, Drejtoria Vendore Kurbin, me shkresë nr. **, datë 19.01.2024, nuk konfirmon pasuri të paluajtshme në emrin e Lorenc Meta dhe familjarëve të tij.

2.2.Në proces verbalin e datës 13.02.2024 subjekti sqaroi se për tokën vreshtë me sip. 8300 m2, dispononte AMTP të vitit 1995 dhe për këtë pronë i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar: kontratë dhurimi pasurie datë 20.04.2018, që konfirmon dhurimin e kësaj sipërfaqe toke nga prindërit e tij.

2.3. Lidhur me deklaratimet ndër vite, për pasuritë e paluajtshme, sqaroi se sipërfaqet e tokave të deklaruara, si vijon: vreshtë rrushi me sip. 9.4 dynym, në Mamurras, përfituar me Ligjin 7501, ullishte 25 dynym dhe 15 dynym tokë të përfituara nga ligji 7501, janë lapsus në deklaram, pasi pronat kanë qenë pa dokumentacion të rregullt hipotekor, apo nuk ishin të azhornuar në hartat kadastrale përkatëse. Familja e subjektit posedonte 13300 m2 tokë vreshtë të përfituar nga Ligji 7501 me AMTP, të cilën në vitin 2018 ja dhuruan subjektit, si dhe 10000 m2 tokë të poseduar nga viti 2005 dhe e blerë në vitin 2015, me kontratë shitblerje në vlerën 3.000.000 lekë, të cilën e zotërojnë aktualisht me certifikatë pronësie. Për deklaramin e pjesës takuese në masën 50% në pasuritë e familjes, sqaroi se ky deklaram është bërë, pasi subjekti është djalë i vetëm dhe bazuar në të drejtën zakonore të zonës që përfaqëson, të gjitha pronat që dispononte familja, deri sa babai është gjallë, i ka deklaram të ndara midis meshkujve të familjes, pra me 50 % pjesë takuese midis tij dhe babait. Për këtë arsye ka deklaram pjesën takuese prej 50% në deklaramat e interesave privatë ndër vite, për pasuritë e paluajtshme. Në deklaramet e mëvonshme, me marrjen e dokumentave hipotekore është qartësuar dhe pronësia e plotë e pasurive të paluajtshme.

2.4. Aktualisht prindërit e subjektit kanë tokë arë (ullishte) me sip. 10000 m², ndodhur në Mamurras, të cilën e kanë pasur në posedim dhe përdorim nga viti 2005 dhe e kanë blerë në vitin 2015, në vlerën 3.000.000 lekë. Likuidimin e vlerës 3.000.000 lekë, babai Lulzim Meta e ka kryer në vitin 2015, me kursime nga të ardhurat e përfituara nga prodhimet e ullinjve nga viti 2005, ndërsa deklaratën noteriale datë 04.03.2009, e cituar në kontratën e shitblerjes së tokës në vitin 2015, babai e ka nënshkruar me këta shtetas, pasi ishte përkujdesur për këtë sipërfaqe toke, duke e shfrytëzuar për prodhimtarinë e ullinjve nga viti 2005, prona ishte e paregjistruar në ZVRPP Kurbin, si dhe për të qenë i garantuar që këta shtetas të mos kryenin shitjen e saj ndaj personave të tjerë.

2.5. Për shtëpinë e banimit në Mamurras, të deklaruar në deklaratat e interesave privatë ndër vite, me zotërim 50%, sqaroi se kjo banesë ka sip. 81 m², me adresë Lagjja "Drita", Mamurras, Kurbin, e regjistruar në bashkëpronësi të prindërve Lulzim Meta dhe Dylbere Meta. Bazuar në të drejtën zakonore të zonës, që përfaqëson edhe këtë pronë, e ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë ndër vite, të ndarë me babain në pjesë takuese 50% secili. Pas hipotekimit shtëpia banimit private është regjistruar në emrin e prindërve, pasi është banesë e ndërtuar para viteve 1990 nga shteti, në të cilën kanë banuar familjarisht. Mirëmbajtjen e shtëpisë e kanë bërë prindërit e subjektit në vite, me të ardhurat e përfituara nga prodhimtaria e ullinjve, pasi nga viti 2005 e deri aktualisht janë marrë me mbjelljen me ullinj të tokës me sip. 10000 m².

2.6. Sqaroi se ka siguruar faturë pagese me OSHEE, datë 21.01.2007, për abonentin Lulzim Meta, për shtëpinë përdhese me adresë Mamurras, pasi para kësaj date, nuk ka pasur sistem apo të dhëna në OSHE, për asnjë abonent.

2.7. Për deklarimin ndër vite të pronës tokë arë me sip. 20 dynym në qytetin e Burrelit me burim trashëgimi, sqaroi se kjo pronë ndodhet në zonën afër Spitalit të Burrelit dhe është trashëguar nga gjyshi Zeqir Meta. Për këtë sipërfaqe toke nuk ka dokumenta pronësie, pasi zona është e paarzhornuar, por njihet që kjo pronë ishte e Zeqir Meta dhe që i është trashëguar babait Lulzim Meta. Deklarimi i kësaj sipërfaqe toke në deklaratat e interesave privatë ndër vite, në pjesë takuese 50% është bërë bazuar në të drejtën zakonore të zonës që përfaqëson.

2.8. Paraqiti:

- Dokumentin nga Bashkia Mamurras, Rrethi Kurbin që vërteton se Lulzim Meta ka përfituar tokën me sip. 8300 m², me nr. tapie **, datë 10.10.1995;
- Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 09.03.2015, për tokën me sip. 10000 m², e ndodhur në Fushë Mamurras Kurbin dhe e regjistruar pranë ZVRPP Kurbin me nr. pasurie **, vol. **, faqe **, zk. 1676, me palë shitëse Q. K. dhe G. K., përfaqësuar me prokure datë 05.03.2015 nga Zeqir Meta (djali i xhaxhait të subjektit) i datëlidjes 24.12.1991 dhe palë blerëse Lulzim Meta, lindur në datë 20.02.1954 në Burrel, Mamurras. Vlera 3.000.000 lekë, e cila është paguar nga blerësi sipas deklaratës noteriale me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 04.03.2009;
- Certifikatë për Vërtetim Pronësie me nr. **, datë 20.04.2015, nga ZVRPP Lac, për pasurinë tokë arë me sip. 10000 m², me nr. pasurie **, zk. 1676, vol. **, faqe **, në pronësi të Dylbere Xhafer Meta dhe Lulzim Zeqir Meta. Bashkëlidhur: Kartela e Pasurisë së Paluajtshme;
- Deklaratë noteriale me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 06.02.2024, përgatitur nga shitësi i tokës G. K. dhe blerësi Lulzim Meta, të cilët deklarojnë në përgjegjësi personale dhe me

vullnetin e tyre të lirë se: "Ne deklaruesit, në muajin mars të vitit 2015 kemi nënshkruar kontratë shitblerje me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 09.03.2015 për pasurinë e paluajtshme tokë arë me sip. 10000 m2 të ndodhur në Fushë - Mamurras Kurbin, me nr. pasurie **, zk. 1676. Deklarojmë se për këtë sipërfaqe toke kemi lidhur një marrëveshje në vitin 2005, por kontrata është nënshkruar në vitin 2015, pasi atëherë është certifikuar prona dhe gjithashtu është likuiduar dhe vlera e shitjes. Pra deklarojmë se pronari aktual Lulzim Meta e ka në përdorim këtë pronë që në vitin 2005". Bashkëlidhur: Pasaportë e shtetasit Lulzim Meta me nr. ID FxxxG; Kartë identiteti e shtetases G. K. me nr. ID FxxxW; Certifikatë për Vërtetim Pronësie nga ZVRPP Lac, për tokën arë me sip. 10000 m2 në pronësi të Dylbere Xhafer Meta dhe Lulzim Zeqir Meta; Harta treguese e regjistrimit; Kartelë pasurie e paluajtshme.

- Certifikatë për Vërtetim Pronësie, me nr. **, datë 06.03.2017, nga ZVRPP Lac, për shtëpi banimi (ndërtesë) me sip. 81.28 m2, me nr. pasurie **, zk.2586, vol. **, faqe. **, me adresë Mamurras, në pronësi të Dylbere Xhafer Meta dhe Lulzim Zeqir Meta. Bashkëlidhur: Harta treguese e regjistrimit; Kartelë e pasurisë së paluajtshme.
- Mandat pagese nga OSHE, datë 21.01.2007, për abonentin Lulzim Meta, kategoria: familjar, shtëpi përdhese me adresë Mamurras, që konfirmon periudhën e pagesës së energjisë elektrike.
- Akt-Vlerësimi, i datës 19.01.2024, nga ana e agronomit të miratuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, me numër LN-5531-xx-2012, numër Nipt KxxxH, Z. P. K., i cili ka vlerësuar se qytetari Lulzim Meta, ka të mbjellë ullishte, sipërfaqe 10 dynym/400 rrënjë ullinj, mbjellë nga viti 2005, nga ku:
 - Vlerëson se në periudhën e viteve 2010 - 2017, ka marrë një prodhim prej 20 kg/rrënjë. Të ardhurat e nxjerra janë 400 rrënjë x 20 kg/rrënjë x 100 lekë për kg, shumëzuar për 7 vite e barabartë me 5.600.000 lekë.
 - Vlerëson se në periudhën 2018 - 2023, ka marrë një prodhim prej 50 kg/rrënjë. Të ardhurat e nxjerra janë 400 rrënjë x 50 kg/rrënjë x 100 lekë për kg, shumëzuar për 5 vite, e barabartë me 10.000.000 lekë. Të ardhurat totale të nxjerra nga kjo sipërfaqe e mbjellë me ullishte për periudhën 2010 - 2023, është e barabartë 15.600.000 lekë. Bashkëlidhur: Licencë nga QKL, për subjektin Pjetër Korriku.

2.9. Subjektit nga ana e Trupës Vlerësuese i është kërkuar të na vërë në dispozicion deklaratën noteriale me nr. 1278 rep., dhe nr. 371 kol., datë 04.03.2009, e cila është administruar nga Trupa në kthim përgjigjet e subjektit të dorëzuara nr. ** prot., datë 12.09.2024 dhe u konstatua se deklaratimet konfirmohen me dokumentacionin e dorëzuar.

2.10. Bazuar në deklarinimin e subjektit dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënvër të përmbledhur rezulton se: Toka vreshtë me sip. 8300 m2, me adresë rrethi Kurbin, fshati Mamurras është përfitur nga subjekti në vitin 2018, me kontratë dhurimi nga prindërit, të cilët e kanë përfitur me AMTP në vitin 1995. Subjekti dha shpjegime lidhur me pasuritë e paluajtshme me adresë Mamurras Kurbin, të deklaruara në deklaratat e interesave privatë ndër vite, si dhe lidhur me kultivimin e tokës bujqësore.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**
- ✓ **ASHK Kurbin nuk e konfirmon tokën me sip. 8300 m2, por subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën certifikatën për vërtetim pronësie.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me deklaratimet ndër vite.**

✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues për tokën arë me sip. 10000 m2, në pronësi të Dylbere Xhafer Meta dhe Lulzim Zeqir Meta.**

3. Vreshtë me sipërfaqe 5000 m2, e përfituar me Ligjin 7501, e ndodhur në Mamurras Laç. Kjo pronë nuk është regjistruar në hipotekë, pasi nuk është azhornuar harta e zonës ku ndodhet. Vlera 0. Zotëron 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Deklaratë noteriale me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 27.04.2018, me deklarues Lulzim Meta dhe Dylbere Meta, të cilët deklarojnë se: “Në bazë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, me numër regjistrimi **, datë 30.12.1994, ne kemi përfituar pasurinë e paluajtshme, lloji vreshtë, me sipërfaqe totale prej 5000 m2, me adresë Mamurras, Rrethi Kurbin. Ne deklarojmë se duam t'ia dhurojmë këtë pronë djalit tonë Lorenc Meta, pasi ai ka shumë vite që është shumë i përkushtuar ndaj saj, e përdor dhe merr frute prej saj. Ne deklarojmë me vullnet të plotë, se jemi plotësisht dakort që të gjithë sipërfaqen e pronës t'ia dhurojmë djalit tonë Lorenc Meta dhe kjo pronë të bëhet e tij, ku ai të ketë të gjitha të drejtat pasurore mbi të. Ne deklarojmë me përgjegjësi ligjore, që këtë pronë në momentin e pajisjes me certifikatë pronësie, do t'ia dhurojmë vetëm djalit tonë edhe në mënyrë ligjore, pasi me gojë ne kemi shumë kohë që i 'a kemi dhuruar, pa kushte dhe pa shpërblim. Unë Lorenc Meta deklaroj me përgjegjësi se: "E pranoj me kënaqësi këtë dhurim dhe ndihem shumë i vlerësuar prej prindërve të mi”.
- Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi me nr. **, datë 30.12.1994, Rrethi: Kurbin, Fshati: Mamurras, që konfirmon se familjes së Dylbere Xhafer Meta, i jepet në pronësi gjithsej tokë vreshtë me sip. 5000 m2.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

3.1.ASHK, Drejtoria Vendore Kurbin, me shkresë nr. **, datë 19.01.2024, nuk konfirmon pasuri të paluajtshme në emrin e Lorenc Meta dhe familjarëve të tij.

3.2.Në proces verbalin e datës 13.02.2024 subjekti sqaroi se për tokën vreshtë me sip. 5000 m2, i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar: Deklaratë noteriale datë 27.04.2018, që konfirmon dhurimin e kësaj sipërfaqe toke nga prindërit e tij, si dhe AMTP, datë 30.12.1994 nga rrethi: Kurbin, Fshati: Mamurras, që konfirmon se familjes së Dylbere Xhafer Meta, i jepet gjithsej tokë vreshtë me sip. 5000 m2. Kjo sipërfaqe toke nuk është e regjistruar në ASHK Drejtoria Vendore Kurbin, pasi kjo zonë akoma nuk është azhornuar.

3.3.Subjektit i është kërkuar nga Trupa Vlerësuese të shpjegojë sesi e ka përfituar mamaja e tij këtë sipërfaqe toke, në afarë cilësie ka qenë ajo Kryefamiljare si marrëse në pronësi të tokës sipas AMTP-së që ka dorëzuar. Gjithashtu ju kërkua të dorëzonte certifikatën e trungut familjar të 1 Gusht 1991, Formularin nr.6 dhe të vërtetonte me dokumentacion se kjo sipërfaqe toke vreshtë nuk është e përfshirë në sipërfaqen 8300 m2, të cilën e zotëroni me certifikatë të rregullt pronësie.

3.4.Me përgjigjet e dorëzuara nr. ** prot., datë 08.07.2024 dhe nr. ** prot., datë 09.08.2024, subjekti ka sqaruar se: “Mamaja ime këtë sipërfaqe toke e ka përfituar nga ligji 7501, pasi ajo në vitin 1991 ka qenë punonjëse e Ndërmarrjes Bujqësore Mamurras. Mamaja ime nuk ka qenë kryefamiljare në këtë kohë, por meqenëse ajo ka qenë punonjëse e

brigadës e cila kishte në mirëmbajtje dhe që punonte në sektorin ku ndodhej ky 5000 m2 tokë, komisioni e ka regjistruar në AMTP pronën në emër të saj.

Me datë 03.07.2024, unë kam aplikuar pranë platformës e-albania për marrjen e certifikatës së trungut familjar të 1 Gusht 1991, me nr. aplikimi HCFIxxxxxxx-001, ku me të ardhur si document do jua dorëzoj. Paraprakisht ju sqaroj se në këtë vit familja ime përbëhej nga im atë kryefamiljar, Lulzim Zeqir Meta, mamaja ime Dylbere Xhaferr Meta, motra ime Aida Lulzim Meta dhe unë Lorenc Lulzim Meta.

Në lidhje me formularin 6, Këshilli i Qarkut Lezhë, na bën me dije se në zyrën e AMT Kurbin nuk gjendet formulari nr.6 për asnjë nga fshatrat e rrethit Kurbin. (bashkëlidhur shkresa)

Për të vërtetuar me dokumentacion se kjo sipërfaqe toke vreshtë, nuk është e përfshirë në sip.8300 m2, të cilën e zotëroj me certifikatë të rregullt pronësie, ju bashkëlidh vërtetimin e Njesisë Administrative Mamurras, datë 03.07.2024 i cili shprehet se sipërfaqja e tokës 5000 m2, me nr. pasurie **, nuk ka lidhje me pasurinë nr. **. (bashkëlidhur vërtetimi)

3.5. Bazuar në deklarinimin e subjektit dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Toka vreshtë me sip. m2, me adresë Kurbin, fshati Mamurras është përfituar nga subjekti në vitin 2018, me deklaratë noteriale dhurimi nga prindërit, të cilët e kanë përfituar me AMTP në vitin 1994. Toka me sipërfaqe 5000 m2, rezulton e pa regjistruar në ASHK Drejtoria Vendore Kurbin dhe nuk është e përfshirë në pasurinë vreshtë me sip.8300 m2.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**
- ✓ **ASHK Kurbin nuk e konfirmon tokën me sip. 5000 m2, por subjekti i ka bëshkëlidhur deklaratë AMTP në emrin e prindërve dhe deklaratën noteriale të dhurimit e vitit 2018.**

4. Ciklomotor, me targa AT777, modeli Road King, Viti 1997, e blerë 1.000 euro, me kontratë nr. rep. **, nr.kol. **, datë 25.08.2020. Vlera 1.000 euro. Zotëron 100 %.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

4.1 DPSHTRR me shkresë me nr. ** prot., 18.09.2023, konfirmon se Lorenc Meta ka të regjistruar mjetin e llojit motor, marka Harley Davidson, tipi Road King, prodhim i vitit 1997, me targë AT 777, nr. shasie IHDIFDKxxVYxxxxx, blerë me Kontratë Shitje (Mjeti) me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 25.08.2020, me palë shitëse shtetasin E. L., në vlerën 1.000 euro, vlerë e cila është likuiduar cash jashtë kësaj zyre.

4.2 Në proces verbalin e datës 13.02.2024 subjekti sqaroi se mjetin motor me targa AT777, modeli Road King e ka blerë në vlerën 1.000 euro, me kontratë datë 25.08.2020, me burim: kursimet nga pagat. Paguesa e kësaj vlere është bërë cash, jashtë sistemit bankar.

4.3 Bazuar në deklarinimin e subjektit dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se mjeti motor model Road King me targë AT 777, në pronësi të subjektit është blerë në vitin 2020 në vlerën 1.000 euro, me burim të ardhurat neto nga pagat.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e DPSHTRR, me burim krijimi të ardhurat nga pagat.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë me kursime familjare.**

5. Kam në sistemin e DRSHTRR Laç, të regjistruar një automjet me targa LA 8659 A, i blerë nga ana ime në vitin 2008. Automjeti është çrregjistruar për efekt të Ligjit 33/2017, datë 31.12.2017, pasi ka shumë vite që është demoluar dhe shkatërruar si makinë. Burimi i krijimit është me kursime familjare dhe të ardhurat nga vreshtaria. Vlera 6.000 euro. Zotëron 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 22.12.2008, për automjetin e markës Mercedes Benz, me targa targa KO2211B, me nr. shasio IVDBxxxAxxxx, me palë shitëse: A. H. dhe palë blerëse: Lorenc Meta, në vlerën 6.000 euro.
- Vërtetim nr. LAFxxx7817 "Për heqjen e përhershme të mjetit nga qarkullimi", datë 17.04.2018, nga DPSHTRR, Drejtoria Rajonale Laç, ku vërtetohet se mjeti me targa LA8659A, i llojit autoveturë i markës Mercedes Benz, me numër identifikimi IVDBxxxAxxxx është hequr nga qarkullimi përfundimisht, në datën 31.12.2017, për arsye të Ligjit 33/2017. Heqja e përhershme nga qarkullimi bëhet sipas kërkesës së aplikantit Lorenc Meta, bazuar në Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, neni 102 dhe Ligjin nr. 9975, datë 22.07.2008, neni 9, i ndyshuar.
- Vërtetim me nr. ** prot., datë 17.04.2018, nga DPSHTRR, Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor Laç, ku vërtetohet se shtetasi Lorenc Meta ka pasur të regjistruar automjetin me targa LA8659A, të llojit Mercedes Benz, mjet i cili ka dalë nga qarkullimi si efekt i Ligjit 33/2017, më datë 31.12.2017.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

- 5.1 DPSHTRR me shkresë me nr. ** prot., 18.09.2023, nuk konfirmon mjetin me targa LA8659A, i llojit Mercedes Benz.
- 5.2 DPSHTRR me email datë 10.01.2024, konfirmon se Lorenc Meta ka pasur të regjistruar në pronësi mjetin Mercedes Benz, me targa LA8659A (ish-targa KO 2211 B), me nr. shasio IVDBxxxAxxxx, blerë me kontratë shitje me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 22.12.2008, me palë shitëse: A. H., në vlerën 6.000 euro.
- 5.3 Në proces verbalin e datës 13.02.2024 subjekti sqaroi se burimi i krijimit për blerjen e automjetit tip Mercedes Benz, me targa LA8659A, në vitin 2008, janë nga kursimet familjare kryesisht nga pagat, si dhe të ardhurat nga prodhimi i vreshtarisë.
- 5.4 Në përgjegjësi të plotë, subjekti deklaroi se automjetin e markës tip Mercedes Benz, me targa LA 8659 A e ka blerë në vlerën 600.000 lekë, por kur ka nënshkruar kontratën e shitblerjes nuk ka qenë i vëmendshëm për të konstatuar vlerën e blerjes, të cilën gabimisht noteri e ka shkruar 6.000 euro. Në deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar, këtë automjet e ka deklaruar duke ju referuar kontratës së shitblerjes. Ka kërkuar të kontaktonte me shtetasin A. H., të cilit i ka blerë këtë automjet në vitin 2008, për ti marrë deklaratë lidhur me vlerën e blerjes së këtij mjeti, por nuk ka mundur pasi

është informuar se ky shtetas ka shumë vite që është larguar familjarisht në Kanada dhe nuk ka pasur asnjë mundësi kontakti me të.

5.5 Bazuar në deklarinë e subjektit dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se: Automjeti tip Mercedes Benz, me targa LA8659A në pronësi të subjektit është blerë në v. 2008, në vlerën 6.000 euro, me burim të ardhurat nga pagat dhe prodhimet bujqësore (vreshtari).

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR, për automjetin tip Mercedes Benz me targa LA 8659 A, blerë në v. 2008 dhe dalë jashtë përdorimit në v. 2017.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë me kursime familjare.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT

- Paga si punonjës Policie, nga viti 2002 deri në dhjetor 2022. Shuma totale 19.722.437 lekë.
- Paga e hedhur tek Raiffeisen Bank, që në Vitin 2005 - 2022 është 18.365.833 lekë.
- Paga nga viti 2002 - 2005 është 1.356.604 lekë.
- Puna me vreshtarinë me sipërfaqe 5.000 m² dhe ullishten e deklaruar më lart me sipërfaqe 8300 m², që në vitin 1994, shuma 600.000 lekë cdo vit.
- Paga e bashkëshortes nga viti 2005 -2022. Shuma 7.861.010 lekë (trajtuar më poshtë)

Bashkëlidhur deklaratës:

- E-mail datë 26.04.2018 nga Shefi i Sektorit të Financës, Drejtoria Vendore e Policisë Kukës, për të ardhurat e z. Lorenc Meta.
- Vërtetim datë 26.04.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria Vendore e Policisë Kukës, që vërteton se z. Lorenc Meta, ka qenë punonjës në DVP Kukës dhe për periudhën e viteve 2002 - 2004, ka përfituar të ardhura në shumën 1.356.604 lekë.
- Vërtetim datë 03.02.2023 nga Raiffeisen Bank, që konfirmon se Lorenc Lulzim Meta me nr. klienti 700194, ka llogari rrjedhëse në lekë me veprime për periudhën e viteve 2005 - shkurt 2023.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. Raiffeisen Bank, me shkresë me nr. ** prot., datë 04.09.2023, konfirmon se Lorenc Meta ka llogari page ku për periudhën 18.05.2005 - 06.03.2023, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga paga, dietat, honorare, shpërblime, trajnime, etj, në shumën rreth 18.099.099 lekë.
2. BKT me shkresë me nr. ** prot., datë 13.09.2023, konfirmon se Lorenc Meta ka llogari rrjedhëse në euro. Në datë 26.12.2014 i është kredituar në llogari shuma 144 euro, nga "Shoqata e të Verbërve " dhe në datë 28.10.2015 i është kredituar në llogari shuma 204 euro nga "Shoqata e të Verbërve ".

3. ISSH me shkresë me nr. ** prot., datë 06.09.2023, konfirmon se Lorenc Meta, për periudhën janar 2012- mars 2023 ka përfituar të ardhura neto nga pagat nga Drejtoria e Policisë së Qarkut, Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier, Drejtoria e Policisë së Qarkut Lezhë, Drejtoria e Policisë Berat, Departamenti për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, Drejtoria e Përgjithshme për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër dhe Drejtoria Vendore e Policisë Durrës.
4. ISSH me shkresën nr. ** prot., datë 06.09.2023, konfirmon se i ka dërguar shkresë Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të konfirmuar të ardhurat e realizuara, për periudhën para vitit 2012.
5. ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror me shkresën kthim përgjigje nr. ** prot., datë 12.09.2023, nuk konfirmon të dhëna për periudhën 1994 - 2012, për shtetasin Lorenc Meta dhe familjarët e tij.
6. Në proces verbalin e datës 13.02.2024, subjekti sqaroi se në periudhën 01.01.2005 - 18.05.2005 ka punuar si Specialist i Policisë Kriminale në Komisariatin e Policisë Sarandë dhe të ardhurat nga pagat neto gjatë këtyre muajve të vitit 2005 ishin rreth 183.200 lekë.
7. Në Policinë e Shtetit ka filluar punë në datë 16.08.2002 dhe nuk ka pasur asnjëherë shkëputje nga puna gjatë periudhës së viteve 2002 - 2023. Bashkëjetesën me bashkëshorten Suela Meta e ka filluar në muajin janar 2004, por celebrimin e martesës e kanë bërë në datë 06.04.2004.
8. Kreditimet në datat 26.12.2014 dhe 28.10.2015 në BKT, respektivisht në shumat 144 euro dhe 204 euro, janë bërë nga "Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë ", e cila kishte një projekt në të cilin aktivizonin edhe Policinë e Shtetit në lidhje me lehtësirat në problematikat që mund të hasnin me personat me aftësi të kufizuar që paraqiteshin pranë institucionit të policisë. Këto likuiditete janë të ardhura të përfituara nga pjesëmarrjes në këtë projekt.
9. Gjendja cash e deklaruar në vitin 2022 është përdorur për shpenzime të ndryshme, si pagesa për arsimin e fëmijëve, etj.
10. Për të ardhurat nga vreshtaria nuk disponon fatura shitje të prodhimeve të vreshtarisë (shitje rrushi) nga viti 1994 e në vijim, pasi ato janë shitur nga prindërit e subjektit në tregun e lirë të fruta-perimeve Laç, Milot dhe Fushë -Krujë. Nuk është i pajisur me NIPT Fermeri, por vetëm i pajisur me kartën e fermerit, nga Agjencia Rajonale e Ekstencionit Bujqësor Shkodër, Sektori i Ekstencionit Bujqësor Lezhë dhe duke mos qenë i regjistruar me NIPT Fermeri nuk ka shlyer detyrime tatimore mbi të ardhurat nga vreshtaria (shitje rrushi), pasi nuk është subjekti i tatimeve.
11. Paraqiti:
 - Vërtetim për Bazën e Vlerësueshme dhe Pagën Neto Mesatare, nga financa e Komisarariatit të Policisë Sarandë, që konfirmon se në periudhën 01.01.2005- 31.12.2005, Lorenc Meta ka përfituar të ardhura neto nga pagat, në shumën 425.400 lekë.

- Konstatohet se për periudhën 01.01.2005 - 18.05.2005 ka përfituar të ardhura neto nga pagat, në shumën rreth 183.200 lekë.
- Vërtetimin nr. ** prot, datë 18.01.2024, nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, që konfirmon se drejtues Lorenc Lulzim Meta është punonjës policie prej datës 16.08.2002 e në vijim.
 - Certifikatën e martesës, datë 30.01.2024, nga Njësia Administrative Mamurras 328, Bashkia Kurbin, që konfirmon se Lorenc Meta dhe Suela Meta (Dangaj) kanë lidhur martesë në datë 06.04.2004.
 - Vërtetim nr. ** prot., datë 09.02.2024, nga "Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë", i cili vërteton se z. Lorenc Meta, ka qenë si ekspert i jashtëm pranë shoqatës së të verbërve të Shqipërisë, si pjesë e projektit "Aksesi në Drejtësi për Personat me Aftësi të Kufizuar", i financuar nga Komisioni European. Z. Meta në sajë të këtij projekti ka marrë 2(dy) pagesa në vitet 2014 - 2015, në vlerat 144 euro dhe 204 euro.
 - Vërtetim me nr. ** prot., datë 16.01.2024, nga Agjencia Rajonale e Ekstencionit Bujqësor Shkodër, Sektori i Ekstencionit Bujqësor Lezhë, ku vërtetohet se fermeri Lorenc Meta, me aktivitet në Bashkinë Kurbin, Njësia Administrative Mamurras, ushtron aktivitetin si fermer nga viti 2000 e në vijim, në veprimtarinë bujqësi-vreshtari - 180-200 kv/ha.
 - Vërtetim me nr. ** prot., datë 16.01.2024, nga Agjencia Rajonale e Ekstencionit Bujqësor Shkodër, Sektori i Ekstencionit Bujqësor Lezhë, ku vërtetohet se fermeri Lulzim Meta me aktivitet në Bashkinë Kurbin, Njësia Administrative Mamurras, ushtron aktivitetin si fermer nga viti 1995 - 2000 e në vijim, në veprimtarinë bujqësi -vreshtari: 180-200 kv/ha.
 - Akt-Vlerësimi "Mbi prodhimin e një sipërfaqe vreshti", datë 19.01.2024, nga z. P. K., agronom i miratuar nga QKL, me LM-5531-xx-2012, numër NIPTI KxxxxxH, ku pasqyrohet se: qytetari Lorenc Lulzim Meta, posedon një sipërfaqe të mbjellë me vreshtë, me varietetet muskat Italian, prej 13.3 dynym nga ku:
 - Vlerëson se në periudhën 1994 - 2000 ka marrë një prodhim rreth 12 kuintal për dynym, e barabartë me 160 kuintal rrush në vit për të gjithë sipërfaqen e mbjellë. Cmimi i referencës i asaj periudhe ka qenë rreth 6500 lekë për kuintal. Të ardhurat totale të nxjerra në një vit, nga kjo sipërfaqe vreshtë, janë 1.040.000 lekë. Ndërsa për 6 Vite x 1.040.000 barabartë me 6.240.000 lekë;
 - Vlerëson se në periudhën e viteve 2000-2010 ka marrë një prodhim rreth 15 kuintalë per dynym, e barabartë me 200 kuintal rrush në vit, per të gjithë sipërfaqen e mbjellë. Cmimi referencës i asaj periudhe ka qenë rreth 10.000 lekë për kuintal. Të ardhurat totale të nxjerra në një vit prodhimi nga kjo sipërfaqe vreshti 15 kuintal x 13.3 dynym x 10.000 e barabartë me 2.000.000 lekë. Ndërsa për dhjetë vite 20.000.000 lekë.
 - Vlerëson se në periudhën e viteve 2010 - 2022 ka marrë një prodhim rreth 15 kuintalë per dynym, e barabartë me 160 kuintal rrush. Cmimi referencës i asaj periudhe ka qenë rreth 12.000 lekë per kuintal. Të ardhurat totale te nxjerra në një vit prodhimi nga kjo sipërfaqe vreshti 15 kuintal x 13.3 dynym x 12.000 lekë e barabartë me 2.400.000 lekë në vit. Ndërsa për 12 vite 12x2.400.000 e barabartë me 28.800.000 lekë. Të ardhurat totale të nxjerra nga kjo sipërfaqe e mbjellë me vreshtë, per periudhën 1994 - 2022 është e barabartë me 55.040.000 lekë. Bashkëlidhur: Licencë nga QKL, për subjektin Pjetër Korriku, me IN-5531-xx-2012, numër NIPTI xxxxxxxxxx.
 - Foto të tokës me vreshtari (në pronësi të subjektit);

- Foto të tokës ullishte (në pronësi të prindërve të subjektit);
 - Ligji nr. 92, për nenet 145, 146,147, 148 të vitit 2014 për TVSH nga Ministria e Financave, si dhe Udhëzimi nr.19, datë 03.11.2014, nga Ministria, për të drejtën e kompensimit të fermerëve (i ndryshuar) me TVSH.
12. Të ardhurat e subjektit nga pagat, shpërblimet, trajnimet, etj., në Policinë e Shtetit, për periudhën e gusht 2002 - mars 2023, të dokumentuara, konfirmohen në vlerën totale rreth 19.261.245 lekë + 348 euro e konvertuar në 19.309.777 lekë.
13. Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor (jo financiar) për tokën bujqësore në Mamurras dhe kultivimin e saj, nga e cila ka deklaruar se për periudhën e viteve 1994 - mars 2023, ka përfiturar të ardhura në shumën rreth 600.000 lekë/vit, përdorur si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë nga babai, në vitin 2006, si dhe për shpenzime familjare.

DETYRIME FINANCIARE

Nuk kam.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur- Periudha 01.01.2022-31.12.2022.

Pagesë dritash - shuma 119.243 lekë. Pagesë uji- shuma 23.000 lekë. Internet + TV. Shuma 18.000 lekë. Telefon (069xxxxxxx është 6.000 lekë); Telefon (069xxxxxxx është 12.000 lekë); Telefon i bashkëshortes 12.000 lekë. Shuma 28.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Librezë nga OSHE, që konfirmon se për vitin 2017 janë kryer pagesa për furnizimin me energji elektrike në shumën totale rreth 119.243 lekë.
- Librezë nga UK Tiranë, në emrin e Lorenc Meta, me nr. kontrate xxx, zona E-3, që konfirmon se për vitin 2017 janë kryer pagesa për furnizimin me ujë, në shumën totale rreth 22.690 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. FSHU me shkresën nr. ** prot., datë 11.09.2023, konfirmon se: Me gjeneralitetet: Lorenc Lulzim Meta, për periudhën deri në datë 10.03.2023, rezulton të ketë lidhur 1(një) kontratë për shërbimin e furnizimit me energji elektrike Nr. TR10030421182545, në instancën Tiranë dhe për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 janë paguar 121.163 lekë; Me gjeneralitetet: Lorenc Meta, për periudhën deri në datë 10.03.2023, rezulton të ketë lidhur 1 (një) kontratë për shërbimin e furnizimit me energji elektrike Nr. TR10030130205014, në instancën Tiranë; Me gjeneralitetet: Suela Kamber Meta, për periudhën deri në datë 10.03.2023, nuk rezulton të ketë lidhur kontratë për shërbimin e furnizimit me energji elektrike, me FSHU; Me gjeneralitetet: Eneid Lorenc Meta, për periudhën deri në datë 10.03.2023, nuk rezulton të ketë lidhur kontratë për shërbimin e furnizimit me energji elektrike, me FSHU. Me gjeneralitetet: Lorela Lorenc Meta, referuar sistemit të faturimit, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë të

furnizimit me energji elektrike me FSHU; Me gjeneralitetet: Erkanda Lorenc Meta, referuar sistemit të faturimit, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike me FSHU.

2. Shoqëria Raionale Ujësjellës - Kanalizime Tiranë Sh.a., me shkresën nr. ** prot., datë 18.10.2023, konfirmon se në emër të Z. Lorenc Lulzim Meta, rezulton kontrata me nr. 386067-1, për objektin me adresë: Rruga “Selitë e Vogël, Kodra e Diellit”, me status Aktiv, në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të likuiduara deri në muajin korrik 2023. Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, rezulton se janë paguar 31.722 lekë. Bashkëlidhur: Kartë identiteti e Lorenc Meta, me ID xxxx; Certifikatë për Vërtetim Pronësie nr. **, për apartament me sip. 122.5 m², zk. 3292. nr. pasurie **, vol. **, faqe **, në bashkëpronësi të shtetasve B. B., M. B. dhe K. B., datë 09.02.2012.
3. Në emër të shtetasve: Suela Kamber Meta, Eneid Lorenc Meta, Lorela Lorenc Meta dhe Erkanda Lorenc Meta, nuk rezulton asnjë kontratë për shërbimin e Ujësjellës Kanalizime Tiranë sha, të regjistruara në sistem në emër të tyre.
4. Katërbëdhjetë (14) Shoqëri Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
5. Në proces verbalin e datës 13.02.2024, subjekti sqaroi se me FSHU ka lidhur kontratën me nr. TR10030421182545, për apartamentin e banimit me sip.122.5 m², me adresë pranë Kopshtit Botanik, Selitë Tiranë, e cila konfirmon shpenzimet për energjinë elektrike për vitin 2022. Lidhur me kontratën me nr. TR 0030130205014, me instancë Tiranë, deklaroi në përgjegjësi personale, se Lorenc Lulzim Meta, i datëlindjes 23.11.1980 (Nr. ID xxxxx) nuk ka lidhur këtë kontratë të furnizimit me energji elektrike me FSHU.
6. Paraqiti: Kopje elektronike të Faturave Tatimore me FSHU, që konfirmojnë se shpenzimet për furnizimin me energji elektrike, për muajt janar 2022 - dhjetor 2022, për kontratën me nr. 0182545, me abonent Lorenc Meta janë në shumën 121.163 lekë.
7. Vodafonë Albania sh.a., me shkresën nr. **, datë 12.01.2024, përcjell CD që, konfirmon se Lorenc Meta i datëlindjes 23.11.1980 (Nr.ID xxxxx) ka të regjistruar numër celulari: 069xxxxxxx, me status aktiv dhe për vitin 2022 rezultojnë pagesa në shumën 7.200 lekë, Lorenc Meta i datëlindjes 23.11.1980, për vitin 2022 ka aktivizuar shërbimin 1 vjekar (internet & televizion) me pagesë 2.600 lekë/muaj. Konstatohet se për vitin 2022 pagesat për internet & television janë në shumën 31.200 lekë.
8. One Albania sh.a. me shkresën nr. ** prot., datë 12.09.2023, konfirmon se: Në emër të Lorenc Lulzim Meta datëlindje 23.11.1980, me ID xxxxx, rezultojnë të regjistruar numrat celularë ONE Albania: 068xxxxxxx; 068xxxxxxx; 068xxxxxxx. Totali i shpenzime për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022 është si vijon: 0698080001 - 9.600 lekë me TVSH, 0698080008 - 9.300 lekë me TVSH, 0685733778 - 4.600 lekë me TVSH. Shtetasit e mëposhtëm nuk rezultojnë të regjistruar në shërbimin e telefonisë mobile, telefonisë fikse / internet në rrjetin ONE Albania: Suela Kamber Meta datëlindje 23.08.1981 me ID IxxxxxJ, Eneid Lorenc Meta datëlindje 12.09.2004 me ID IxxxxxP, Lorela Lorenc Meta datëlindje 30.03.2008 me ID IxxxxxN, Erkanda Lorenc Meta datëlindje 06.01.2014 me ID LxxxxxS.

9. Albania Satellite Communications sh.a. me shkresën nr. ** prot., datë 12.09.2023 nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të.
10. Abissnet sh.a. me shkresën nr. ** prot., datë 18.09.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të.
11. Digicom sh.a. me shkresën nr. ** prot., datë 11.09.2023, konfirmon se subjekti i vlerësimit Lorenc Meta dhe personat e lidhur me të, nuk kanë marrë shërbim interneti nga shoqëria Digicom, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.
12. Në proces verbalin e datës 13.02.2024 subjekti sqaroi se ka regjistruar në emrin e tij edhe numrin 068xxxxxxx, të cilin e ka blerë për llogari të nënës Dylbere Meta. Vlera e shpenzuar në periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, në shumën 4.600 lekë, që konfirmohet nga ONE Albania është vlera që ajo ka paguar gjatë kësaj periudhe me të ardhurat e saj familjare dhe nuk është shpenzim i subjektit. Është interesuar pranë kompanisë ONE Albania për transferimin e numrit nga emri i tij në emrin e nënës Dylbere Meta, por është sqaruar pranë dyqaneve të kësaj kompanie, se duhej kohë për të realizuar këtë transferim numri.
13. Shpenzimet për ujë + drita + telefon + internet, gjatë periudhës 01.01.2022 - 31.12.2022 janë në shumën rreth 210.000 lekë,
14. Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara- Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022:
- Dalë jashtë shtetit (me familjen) 02.01.2020 - 07.01.2020, në Maqedoni, me paketë turistike. Udhëtim nga Qafë - Thana. Shuma 450 euro.
 - Dalë jashtë shtetit (me bashkëshorten) 13.11.2020 - 5.12.2020, në Itali tek motra ime, nga Porti Durrësit. Shuma 1.300 euro.
 - Dalë jashtë shtetit (me familjen) 02.07.2021 - 12.07.2021, në Greqi tek familjarët e mi, nga Qafë - Bota, Sarandë. Shuma 1.600 euro.
 - Dalë jashtë shtetit me bashkëshorten, tek motra në Itali, nga data 23.08.2021 - 25.08.2021, nga Rinasi. Shuma 280 euro.
 - Dalë jashtë shtetit me bashkëshorten, në Francë, nga data 08.06.2022 - 10.06.2022, nga Rinasi. Shuma 340 euro.
 - Dalë jashtë shtetit me familjen, tek motra në Itali, nga data 17.07.2022 - 30.07.2022 nga Porti i Durrësit. Shuma 1.700 euro.
 - Dalë jashtë shtetit vetëm, te kushëriri në Gjermani, nga data 17.11.2022 - 19.11.2022, nga Rinasi. Shuma 210 euro.
15. Në proces verbalin e datës 13.02.2024 subjekti sqaroi se lëvizjet jashtë shtetit, duke ju referuar dokumentave nga sistemi TIMS, janë si më poshtë:
- a. Udhëtim me familjen në Maqedoni, me paketë turistike, nga data 02.01.2020 - 07.01.2020. Udhëtimin e kanë kryer me automjetin privat në pronësi të babait të subjektit Lulzim Meta, nga pika kufitare Qafë- Thanë. Nuk ka ruajtur dokument justifikues nga agjencia turistike për shpenzimet e deklaruara. Në total ka shpenzuar 450 euro që

- përfshijnë 50 euro karburant për mjetin dhe 400 euro paketa turistike, që përfshinte hotelin dhe ushqim.
- b. Udhëtim me bashkëshorten Suela Meta në Itali, për arsye shëndetësore nga data 13.11.2020 - 5.12.2020. Udhëtimin e kanë kryer me traget nga Porti Durrësit. Nuk ka ruajtur biletat e udhëtimit. Ka shpenzuar rreth 1.300 euro ku përfshihen biletat e udhëtimit (rreth 860 euro) së bashku me mjetin privat, karburant, shërbime kafeje dhe shpenzime të tjera. Këto shpenzime ishin përveç shpenzimeve spitalore të cilat i ka parapaguar me transfertë bankare nga llogaria në Raiffeisen Bank, plus një shtesë pagese prej rreth 1.020 euro, e kryer në llogarinë e spitalit në Intesa SanPaolo Bank (trajtuar më poshtë Në Firenze, Itali, pasi është takuar me motrën A. G. është shtruar në Spitalin "Azienda Ospedaliero Universitaria Careggi", ku ka qëndruar deri në datë 03.12.2020, ndërsa bashkëshortja Suela Meta ka qëndruar në shtëpinë e motrës së subjektit, A. G., e cila jeton dhe punon familjarisht nga viti 1998, në Firenze Itali.
 - c. Udhëtim me familjen për pushime ne Korfuz, Greqi, nga data 02.07.2021 - 12.07.2021, ku ka qëndruar tek kushëriri D.S. Udhëtimin e kanë kryer me mjetin privat në pronësi të babait Lulzim Meta, nga pika kufitare Qafë-Botë, Sarandë. Nuk dispononte fatura pagesash për shpenzimet e deklaruara. Ka shpenzuar në total rreth 1.600 euro, ku përfshiheshin karburanti për mjetin dhe shpenzime për blerje të ndryshme dhe ushqim. Akomodimi i është mbuluar nga kushëriri D. S., i cili jeton dhe punon familjarisht në Korfuz, Greqi, nga viti 1996, pasi kanë qëndruar në shtëpinë e tij.
 - d. Udhëtim me bashkëshorten Suela Meta, për vizitë tek motra A. G., në Firenze, Itali, nga data 23.08.2021 - 25.08.2021. Udhëtimin e kanë kryer me avion nga Aeroporti i Rinasit. Ka shpenzuar në total rreth 280 euro që përfshin biletat e avionit dhe shpenzime kafeje në aeroport, pasi janë akomoduar në shtëpinë e motrës së subjektit Aida Goci. Nuk disponon kopje të biletave të udhëtimit.
 - e. Udhëtim me bashkëshorten Suela Meta, në Paris, Francë, me paketë turistike nga data 8.06.2022 - 10.06.2022. Udhëtimin e kanë kryer me avion nga Aeroporti i Rinasit. Ka shpenzuar në total rreth 340 euro për dy ditë qëndrimi, ku përfshihen biletat e udhëtimit, ushqim, fjetje dhe shpenzim kafeje. Nuk ka ruajtur dokumenta justifikues që konfirmojnë këto shpenzime.
 - f. Udhëtim me familjen për vizitë tek motra A. G., në Firenze, Itali, nga data 17.07.2022 - 30.07.2022. Udhëtimin e kanë kryer me traget nga Porti Durrësit. Ka shpenzuar në total rreth 1.700 euro ku përfshihen biletat e tragetit (rreth 980 euro) dhe shpenzime karburanti, kafeje, blerje të ndryshme, etj. Janë akomoduar tek motra e subjektit dhe nuk kanë pasur shpenzime për akomodim. Nuk disponon biletat e udhëtimit apo fatura për shpenzimet e tjera.
 - g. Udhëtim personal i subjektit në Frankfurt Gjermani, për vizitë tek djali i xhaxhait A. Meta, nga data 17.11.2022 deri në 19.11.2022. Udhëtimin e ka kryer me avion nga Aeroporti i Rinasit. Ka shpenzuar në total 210 euro ku përfshihen biletat e udhëtimit dhe shpenzim kafeje për dy ditë qëndrimi. Është akomoduar në shtëpinë e kushëririt A. Meta, i cili jeton dhe punon në Frankfurt, Gjermani dhe shpenzimet e ushqimt janë mbuluar prej tij.
 - h. Përveç udhëtimeve të sipërcituara, të deklaruara në deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar, kanë kryer edhe disa udhëtime të tjera, si vijon: Udhëtim me familjen në Romë, Itali, nga data 19.08.2022 deri në 21.08.2022. Udhëtimin e kanë kryer me avion nga Aeroporti i Rinasit. Ka shpenzuar në total rreth 450 euro, ku përfshihen biletat e

udhëtimit, akomodim dhe ushqim. Nuk ka ruajtur dokumenta që konfirmojnë këto shpenzime.

- i. Bashkëshortja Suela Meta ka shkuar në Stamboll Turqi, nga data 26.05.2022 deri në 29.05.2022, me paketë turistike nga Agjencia A.T.H.S. Udhëtimin e ka kryer me një shoqe të punës, me avion nga Aeroporti i Rinasit. Kanë shpenzuar në total 55.198 lekë, nga të cilat bashkëshortja e subjektit ka paguar 50 % të vlerës, në shumën rreth 28.000 lekë, që përfshin biletat e udhëtimit, akomodim dhe ushqim.
- j. Djali Eneid Meta ka dalë jashtë shtetit nga data 20.06.2021 deri në 26.06.2021, në Bosnjë Hercegovinë, nga Kolegji "Turgut Ozal". Udhëtimin e ka kryer me furgon/autobus. Shpenzimet në total, për akomodim dhe ushqim, janë mbuluar nga kolegji. Shuma që ka shpenzuar vecmas djali i subjektit ishte 60 euro. Nuk kanë ruajtur dokumenta që konfirmojnë këto shpenzime.
- k. Djali Eneid Meta ka dalë jashtë shtetit personalisht, nga data 22.08.2021 deri në 05.09.2021, në Romë, Itali, i ftuar nga kushëriri i subjektit, z. A. Meta, i cili jeton dhe punon në Romë Itali. Udhëtimin e ka kryer me avion nga Aeroporti i Rinasit. Në këtë rast shpenzimet në total, për bileta udhëtimi, akomodim dhe ushqim, janë mbuluar nga kushëriri i subjektit, A. Meta. Shuma që ka shpenzuar vecmas djali i subjektit ishte 100 euro. Nuk ka ruajtur dokumenta që konfirmojnë këto shpenzime.
- l. Djali Eneid Meta ka dalë jashtë shtetit nga data 21.06.2022 deri në 24.06.2022, në Romë Itali, nga Kolegji "Turgut Ozal". Udhëtimin e ka kryer me avion, nga Aeroporti i Rinasit. Shpenzimet për akomodim dhe ushqim janë mbuluar nga kolegji, ndërsa biletat e udhëtimit dhe shpenzimet e tjera janë mbuluar nga familja dhe ishin në shumën 210 euro. Nuk ka ruajtur dokumenta që konfirmojnë këto shpenzime.
- m. Djali Eneid Meta ka dalë jashtë shtetit personalisht, nga data 13.10.2022 deri në 18.10.2022, në Amsterdam, Hollandë, pasi ishte i ftuar nga Universiteti i Amsterdimit. Udhëtimin e ka kryer me avion nga Aeroporti i Rinasit. Shpenzimet për biletat e udhëtimit dhe shpenzime ushqim, etj., janë mbuluar nga familja dhe ishin në shumën 350 euro ndërsa akomodimi është mbuluar nga universiteti. Nuk ka ruajtur dokumenta që konfirmojnë këto shpenzime.

16. Këto udhëtime subjekti nuk i ka deklaruar, pasi nuk ka qenë i vëmendshëm gjatë verifikimit të dokumentave nga sistemi TIMS.

Paraqiti:

- Dokument nga sistemi TIMS, datë 26.01.2024 që vërteton udhëtimet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të Lorenc Meta, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, si më sipër cituar.
- Dokument nga sistemi TIMS, datë 26.01.2024, që konfirmon udhëtimet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bashkëshortes Suela Kamber Meta, e datëlindjes 23.08.1981 për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, si më sipër cituar.
- Deklaratë personale datë 07.02.2024, nga motra e subjektit, znj. A. G. (Meta), lindur në Mamurras, në datë 03.10.1978 dhe banuese në Via Delle Cantine ** San Cipriano (Arezzo) **, e cila deklaron në përgjegjësi ligjore se: "Vëllai Lorenc Meta jo vetëm në datat 13.11.2020 - 05.12.2020 (kohë që ka qenë i shtruar në spital dhe bashkëshortja e tij ka qëndruar tek unë dhe të gjitha shpenzimet që ka bërë janë hequr nga unë, 23.08.2021 - 25.8.2021 dhe 07.07.2022 - 30.7.2022, por edhe gjitha herët që ai ka ardhur në Itali, shpenzimet përjetje, ushqim dhe qëndrim janë hequr nga ana ime, pasi unë kam ardhur në vitin 1998 dhe deri më sot e në vazhdim kam punuar dhe jetuar në Firenze, Itali".

Bashkëlidhur kopje e Pasaportës e S. G. me nr. ID HxxxxxB (bashkëshorti i motrës së subjektit); Leje Qëndrimi (Soggiornante) nga shteti Italian për S. G.; kopje e Pasaportës e A. G., me nr. ID HxxxxxP (motra e subjektit); Leje Qëndrimi (Soggiornante) nga shteti Italian, për A. G.

- Deklaratë personale, datë 09.02.2024, nga kushëriri i subjektit, z. D. S., i cili deklaroi me përgjegjësi se: "Me Lorenc Meta jemi kushërinj të largët, por jemi lindur dhe rritur bashkë, pasi kemi banuar në shtëpi ngjitur në Mamurras, si komshinj. Duke qenë se unë jetoj, banoj dhe punoj në Greqi e kam thirrur për të kaluar pushimet bashkë, nga data 02.07.2021 deri në datë 12.07.2021, ne shtëpinë time në Korfuz, ku unë kam punuar e jetuar tërë ato vite. Lorenci së bashku me familjen ka qëndruar në shtëpinë time, pa paguar asgjë ". Bashkëlidhur kopje e Pasaportës e D. S., me ID IxxxxxE; Leje Qëndrimi nga shteti grek për D. S.
- Deklaratë personale nga djali i xhaxhait të subjektit, Z. A. Sh. Meta, i datëlindjes 26.07.1986, i cili deklaroi se: "Jam djali i xhaxhait të Lorenc Meta dhe prej disa vitesh jetoj në Gjermani Wehminger Garten **, Hanover. Lorenci ka ardhur për vizitë tek unë në datat 17.11.2022 deri në 19.11.2022. Të gjitha shpenzimet për akomodim, ushqim, transport etj, jam marrë unë me to dhe ai nuk ka paguar asgjë. Bashkëlidhur kopje e Pasaportës e A. Meta, me ID xxxxxxx.
- Faturën Tatimore me nr. **, datë 16.05.2022, nga A.T.H.S, që konfirmon pagesën e Suela Meta dhe V. D., në shumën totale 55.198 lekë.

17. Në datën 16.02.2024 subjekti paraqiti në Zyrën e Protokollit në ILDKPKI: si më poshtë vijon:

- Dokument nga sistemi TIMS, datë 15.02.2024, që vërteton udhëtimet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të Eneid Meta, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, si më sipër cituar.
- Dokument nga sistemi TIMS, datë 15.02.2024, që vërteton udhëtimet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të Lorela Meta, për periudhën 01.01.2020 -31.12.2022, si më sipër cituar.
- Dokument nga sistemi TIMS, datë 15.02.2024, që vërteton udhëtimet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të Erkanda Meta, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, si më sipër cituar.

18. Subjektit nga ana e Trupës Vlerësuese i janë dërguar pyetje shtesë në lidhje me udhëtimet jashtë vendit dhe konkretisht:

“Pranë ILDKPKI-së keni shtuar edhe disa udhëtime të tjera të kryera nga ju dhe familjarët tuaj për tre vitet e fundit. Në lidhje me udhëtimin tuaj në Romë nga data 19.08.2022-21.08.2022 keni deklaruar rreth 450 euro shpenzime për bileta akomodim dhe ushqim. Shpreheni se nuk keni ruajtur dokumenta që konfirmojnë këto shpenzime. Sqaroni me përafërsi sa janë biletat e avionit për 5 personat e familjes tuaj, pasi shuma që keni deklaruar si shpenzim total i udhëtimit në dukje rezulton të jetë vetëm shpenzim për bileta udhëtimi, detajoni dhe shpenzimet e tjera për akomodim dhe ushqim për 5 persona”. Subjekti në kthim përgjigjet nr. 60/25 prot., datë 09.08.2024, ka sqaruar: “Ju sqaroj se kushërira ime M. R. Meta e datëlindjes 19.08.1972, nr. ID H.....R, kishte datëlindjen, 50 vjetor. Familjarët i bënë një festë surprizë dhe të gjitha shpenzimet janë hequr nga ata si akomodim, ushqim etj, për këtë fakt është ajo shumë e deklaruar. Po të shikohet dhe udhëtimi ynë është bërë më datë 19.08.2022, që most ë prishnim këtë gëzim familjar. Dokumentacioni për këtë fakt nuk disponoj.”

Sqarimi përpulhet me verifikimet e kryera nga Trupa Vlerësuese dhe u pranua shuma e shpenzuar sipas deklaramit të subjektit.

Pyetje: “Në lidhje me udhëtimet e djalit tuaj në datat 20.06.2021-26.06.2021 në Bosnjë Hercegovinë dhe 21.06.2022 -24.06.2022 në Romë keni sqaruar se shpenzimet janë mbuluar nga Kolegji Turgut Ozal. Paraqisni dokumentacion vërtetues justifikues për këtë fakt.”

Subjekti ka sqaruar: “Në këtë moment e kam të pamundur gjetjen e dokumentacionit të kërkuar. Ai ka fjetur dhe ushqyer tek shkolla Turgut dhe ekuivalentët e saj, me të ardhur në Shqipëri mësuesi kujdestar që i ka shoqëruar, me patjetër që do i marr një deklaratë noteriale për këtë fakt.”

Megenëse ende nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues, në shpenzimet për udhëtim, nga ana e Trupës janë marrë në konsideratë 6 netë x 50 euro + 30 euro transport dhe 3 netë x 50 euro +100 euro bileta, të cilat u shtuan si shpenzime udhëtimi në pasqyrën e analizës financiare.

Pyetje: “Gjithashtu pohoni se djali juaj nga 22.08.2021-05.09.2021 ka qenë i ftuar nga kushëriri Aldo Mera. Nuk keni paraqitur asnjë dokument që konfirmon këtë fakt.”

Subjekti ka sqaruar: “Për të dokumentuar këtë fakt po ju dorëzoj bashkëlidhur deklaratën noteriale nr.3937 rep., dhe nr.1306 kol., datë 20.08.2021, ku përveçse i japim lejen që djali ynë të jetë në udhëtim me A. M., aty është e shënuar dhe që ai do të qëndrojë në shtëpinë e kushëririt të tij, Aldo Mera në Romë. Po kështu në TIMS është e vërtetueshme se kanë udhëtuar bashkë më datë 22.08.2021, nga aeroporti i Rinasit.”

Trupa Vlerësuese pasi administroi dokumentacionin e lartpërmendur, kreu verifikimet e nevojshme dhe mori në konsideratë shpjegimin e subjektit duke shtuar si shpenzim udhëtimi vetëm biletën 100 euro.

Nga kontrolli i llogarive bankare kanë rezultuar këto veprime bankare:

- Datë 12.07.2022 prenotim Hotel on AMS – 54584 lekë
- Datë 28.09.2022 Opodo – 11377 lekë
- Datë 16.10.2022 Opodo Barcelona -14558 lekë
- Datë 28.10.2022 Opodo Prime – 6569 lekë
- Datë 04.01.2023 Hotel Dream House Kolashin -112148 lekë
- Datë 13.01.2023 VunetLogin VAMSTE-11734 lekë
- Datë 17.01.2023 Eëzz Air -7358 lekë
- Datë 27.01.2023 Eëzz Air -17040 lekë.

Subjekti sqaroi se “janë shpenzime udhëtimi dhe se rezervimet e biletave janë bërë në kohë para se të udhëtojnë për arsye ekonomike, se janë prerë më lirë.”

19. Të gjitha këto shpenzime u morën në konsideratë në pasqyrën e analizës financiare të subjektit dhe personave të lidhur me të.

20. Shpenzimet për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur, gjatë periudhës së sipërcituar, rezultojnë në total, konvertuar në shumën rreth 878289 lekë.

21. Për arsimin e fëmijëve madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të

Vlerësimet. Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë. Shkollimi i djalit Eneid Meta, tek Kolegji Turgut Ozal. Shuma 3.160 euro. Shkollimi i vajzës Erkanda Meta, tek shkolla jo publike INDIPENDENT. Shuma 1.040 euro. Shkollimi i vajzës Lorela Meta, tek shkolla jo publike INDIPENDENT. Shuma 1.200 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim datë 11.04.2018, nga shkolla 9-vjecare private "Udha e Shkronjave", që vërteton se Eneid Meta dhe Lorela Meta e kanë pagesën vjetore të shkollës 150.000 lekë. Në këtë cmim nuk janë përfshirë kurset online, ushqimi dhe transporti.
 - Kthim përgjigje me nr. 2023/064 prot., datë 08.03.2023, nga Institucioni Arsimor "Turgut Ozal" që vërteton se për nxënësin Eneid Lorenc Meta, pagesat e kryera për vitin akademik 2022 - 2023 janë 3.160 euro.
 - Faturë tatimore datë 30.12.2022, nga Kolegji "The Independent", që vërteton se për shërbimin arsimor të Lorela Lorenc Meta është kryer pagesa e këstit për klasën e IX, viti akademik 2022 - 2023, në shumën 1.200 euro ose 137.916 lekë.
 - Faturë tatimore shitje, datë 30.12.2022, nga Kolegji "The Independent", që vërteton se për shërbimin arsimor të Erkanda Lorenc Meta është kryer pagesa e këstit për klasën e III, viti akademik 2022 - 2023, në shumën 1.040 euro ose 119.527 lekë.
22. Në proces verbalin e datës 13.02.2024 subjekti sqaroi se, djali Eneid Meta ka studiuar pranë shkollës jopublike "Udha e Shkronjave " në periudhën e viteve 2011 - 2020, duke kryer ciklin 9 vjeçar me pagesë vjetore 75.000 lekë dhe, në total, për gjithë ciklin 9 vjeçar, kanë shpenzuar 675.000 lekë; Vajza Lorela Meta ka studiuar pranë shkollës jopublike "Udha e Shkronjave " në periudhën e viteve 2014 - 2021, me pagesë vjetore 75.000 lekë dhe, në total, për 8 vite shkollim, kanë shpenzuar 600.000 lekë; Vajza Erkanda Meta ka studiuar pranë shkollës jopublike "Udha e Shkronjave " në klasën e I dhe të II, në periudhën e viteve 2019 - 2020 dhe 2020 - 2021, me pagesë vjetore 75.000 lekë dhe, në total, për 2 vite shkollim, kanë shpenzuar 150.000 lekë. Pagesat janë kryer me mandat pagesë pranë institucionit arsimor.
23. Nisur nga vlera e ulët e tarifës së shkollimit pranë shkollës jo publike "Udha e Shkronjave", Trupa Vlerësuese i ka kërkuar sqarime shtesë dhe dokumentacion vërtetues këtij institucioni arsimor, i cili me shkresë nr. ** prot., datë 16.07.2024, na ka dhënë sqarime shtesë si dhe ka listuar tetë kritere justifikuese mbi politikën e shkollës në lidhje me uljen specifike të tarifës për një kategori të caktuar sipas kritereve përkatëse në fuqi.
24. Djali Eneid Meta, ka studiuar 3(tre) vite të shkollës së mesme në institucionin arsimor "Turgut Ozal" dhe konkretisht në vitet arsimore: 2020 - 2021, 2021 - 2022 dhe 2022 - 2023. Pagesat vjetore për vitet 2020 - 2021 ishin në shumën 3.450 euro, për vitet 2021 - 2022 në shumën 3.650 euro dhe për vitet 2022 - 2023 në shumën 3.160 euro. Në total, për 3 vite kanë shpenzuar 10.260 euro. Pagesat i kanë kryer pranë këtij institucioni arsimor, janë kryer me mandat pagesa.
25. Vajzat, Lorela Meta dhe Erkanda Meta kanë filluar shkollimin në Kolegjin "The Independent" në vitin 2022 dhe deri në plotësimin e deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, shpenzimet e shkollimit të tyre ishin: Për vajzën Lorela Meta është kryer pagesa e këstit për klasën e IX, viti akademik 2022 - 2023, në shumën 1.200 euro, ndërsa, për vajzën Erkanda Meta është kryer pagesa e këstit për klasën e III, viti akademik 2022 - 2023, në shumën 1.040 euro.

26. Deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti i ka bashkëlidhur faturë tatimore datë 30.12.2022, nga Kolegji "The Independent", që vërtetojnë pagesat për shërbimin arsimor për Lorela Meta dhe Erkanda Meta.
27. Burimi i krijimit për mbulimin e shpenzimeve për shkollimin e fëmijëve janë të ardhurat familjare nga pagat, si dhe të ardhurat nga vreshtaria, të cilat i kanë menaxhuar edhe në gjendje cash në shtëpi.
28. Paraqiti:
- Vërtetim datë 29.01.2024 nga institucioni shkollor "Udha e Shkronjave", që konfirmon shpenzimet për shkollimin e djalit Eneid Meta në periudhën e viteve 2011 - 2020, duke kryer ciklin 9 vjeçar dhe detyrimi i paguar ishte në shumën totale 675.000 lekë.
 - Vërtetim datë 29.01.2024 nga institucioni shkollor "Udha e Shkronjave", që konfirmon shpenzimet për shkollimin e vajzës, Lorela Meta, në periudhën e viteve 2014 - 2021, ku ka përfunduar klasën 1 - 8 dhe detyrimi i paguar ishte në shumën totale 600.000 lekë.
 - Vërtetim datë 29.01.2024 nga institucioni shkollor "Udha e Shkronjave", që konfirmon shpenzimet për shkollimin e vajzës, Erkanda Meta, në periudhën e viteve 2019 - 2021, ku ka përfunduar klasën 1 - 2 dhe detyrimi i paguar ishte në shumën totale 150.000 lekë.
 - Vërtetimin me nr. ** prot., datë 09.02.2024, nga Institucioni Arsimor "Turgut Ozal", që vërteton se Eneid Meta ka studiuar pranë këtij kolegji dhe për vitet akademike ka paguar si vijon: për vitet 2020 - 2021, në shumën 3.450 euro, për vitet 2021 - 2022, në shumën 3.650 euro dhe për vitet 2022 - 2023, në shumën 3.160 euro.
29. Nga transfertat bankare rezultuan të jenë kryer veprimet e mëposhtme:
Në datë 12.02.2019 transferuar nga RFZ Bank 36.050 lekë për Universitetin A.Xhuvani ndërsa në datë 27.06.2021 transfertë për Ornela Laho 35.600 lekë; Datë 30.03.2022 nga RFZ bank për College Boards 21805 lekë; Erasmus Univ.Rott 11.708 lekë datë 12.01.2023; Mollie Soëiso BV. 38.397 lekë datë 17.02.2023.
Subjekti në kthim përgjigjet e tij ka sqaruar se këto shpenzime janë tarifa për shkollim pranë Universitetit A.Xhuvani(dy të parat), pagesë regjistrimi i djalit në kualifikim të gjuhës angleze, regjistrim për pranim në Universitetin Erasmus Rotterdam dhe certifikatë e njohurive në matematikë, për degët e ekonomikut. Subjekti paraqiti dokumentacion justifikues bashkëlidhur.
30. Të gjitha këto shpenzime janë marrë në konsideratë në analizën financiare, duke u llogaritur tek zëri shpenzime për arsim.
31. Në shpenzimet për arsim janë mbajtur parasysh dhe ato të kryera nga subjekti pranë Universitetit Kristal dhe Universitetit "Fan Noli", sipas diplomave përkatëse dhe tarifave të përlllogaritura.
32. Shpenzimet e deklaruara për arsimin e fëmijëve, subjektit dhe bashkëshortes, gjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë rezultojnë në total e konvertuar në vlerën rreth 4483041 lekë.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES - SUELA META

DEKLARIMI I PASURIVE

1. **Automjet tip Benz GLK, Viti prodhimit 2011, me targa AB 305 AE, blerë me datë 02.06.2020, në bashkëpronësi me motrën time B. D. Është marrë me faturë tatimore me subjektin "Auto Lux", me NIPT LxxxxxK. Burimi i krijimit është shitja e automjetit të mëparshëm tip Opel Corsa, AA 420 EV, blerë më 14.12.2012, me kontratë nr. ** rep., dhe nr. ** kol., shitur 3.500 euro. Vlera 6.080 euro. Zotëron 50%. Bashkëlidhur deklaratës:**
 - Faturë tatimore shitje datë 02.06.2020, për automjetin e markës Mercedes Benz GLK 220 CDI, me palë shitëse E. H. PF me NIPT LxxxxxK dhe palë blerëse Suela Meta dhe B. D., në vlerën 6.080 euro ose 741.809 lekë (kursi i këmbimit 122 lekë/euro).

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

- 1.1. DPSHTRR me shkresën nr. ** prot., 18.09.2024, konfirmon se Suela Meta dhe B. D. kanë pasur të regjistruar, në bashkëpronësi, automjetin me targa AB 884 KT (ish targa: AB 305 AE), marka Mercedes Benz GLK 220 CDI, blerë me faturë tatimore shitje datë 02.06.2020, me palë shitëse Erol Hysi PF, me NIPT LxxxxxK, në vlerën 6.080 euro ose 741.809 lekë (kursi i këmbimit 122 lekë/euro).
- 1.2. Me Kontratë Shitje Pasurie të Luajtshme (automjet) me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 09.05.2023, rezulton se shtetaset Suela Kamber Meta dhe B. K. D., përfaqësuar me Prokurë të Posacme me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 03.05.2023 nga shtetasi S. Gj., kanë shitur automjetin me targa AB 305 AE, me palë blerëse A. P., në vlerën 12.000 euro.
- 1.3. DPSHTRR me e-mail datë 10.01.2024, konfirmon se mjeti me targa AA 420 EV, aktualisht, nuk është dhe nuk ka qenë i regjistruar në pronësi të shtetasës Suela Kamber Meta.
- 1.4. Në procesverbalin e datës 13.02.2024 subjekti sqaroi se diferenca që rezulton midis çmimit të blerjes në vitin 2020 në vlerën 6.080 euro, me çmimin e shitjes në vitin 2023 në vlerën 12.000 euro, të automjetit të markës Mercedes Benz GLK 220 CDI, me targa AA 305 AE, në bashkëpronësi të bashkëshortes Suela Meta me motrën e saj B. D. është pasi ky automjet është blerë jo në gjendje të mirë teknike dhe strukturore dhe kishte të nevojshme kryerjen e shërbimeve xhenerike dhe mekanike. Për ta bërë mjetin në gjendje shumë të mirë teknike ka kryer disa shërbime tek Servis "VELIJA", Bërdicë, Shkodër. Pas shërbimeve të kryera është rritur vlera e mjetit, pasi është bërë në gjendje shumë të mirë teknike dhe strukturore.
- 1.5. Automjeti tip Opel Corsa, me targa AA 420 EV është blerë me kontratë shitblerje datë 04.12.2012 nga bashkëshortja Suela Meta në vlerën 3.500 euro, por nuk ishte bërë regjistrimi i pronësisë së këtij mjeti në atë kohë në DPSHTRR për shkak të neglizhencës së bashkëshortes. Bashkëshortja Suela Meta, në muajin mars të vitit 2020, ka shitur automjetin tip Opel Corsa ndaj shtetasit A. Rr. në vlerën 3.500 euro, pa kontratë

shitblerje, pasi nuk dispononte certifikatën e pronësisë së këtij mjete. Pagesat për blerjen dhe shitjen e këtij mjete janë kryer jashtë sistemit bankar në cash.

1.6. Në datë 08.02.2024 ka bërë regjistrimin e pronësisë së mjetit Opel Corsa në DPSHTRR, në emrin e bashkëshortes Suela Meta, si dhe kanë marrë deklaratë noteriale nga shtetasi A. Rr. lidhur me shitjen e këtij mjete në vitin 2020 në vlerën 3500 euro. Pas plotësimit të dokumentacionit të mjetit është bërë çregjistrimi i këtij mjete në DPSHTRR, duke e nxjerrë nga qarkullimi i përhershëm, pasi mjete ishte plotësisht në gjendje të amortizuar.

1.7. Mosdeklarimi i blerjes së automjetit tip Opel Corsa, në pronësi të bashkëshortes, me targa AA 420 EV, në deklaratat e interesave privatë ndër vite është harresë. Burimi i krijimit janë të ardhurat familjare nga pagat dhe të ardhurat nga shitja e automjetit tip Volksëagen Polo në vlerën 1.000 euro në muajin nëntor 2012.

1.8. Paraqiti:

- Deklaratë (e pa noterizuar) dalë 21.11.2023, nga shitësi i mjetit E. H. PF, me nipt LxxxxxK, i cili deklaron se: "Në datë 02.06.2020 i ka shitur shtetaseve: Suela Meta me NID IxxxxxJ dhe B. M. me NID IxxxxxD automjetin Mercedes Benz GLK 220 CDL prodhim i vitit 2010, me targa AA 305 AE, në vlerën lokale prej 6.080 euro, pasi automjete nuk ishte në gjendje të mirë teknike dhe strukturore".
- Faturë dalje datë 13.06.2020 për shërbimin e kryer tek Servis "VELIJA", Bërdicë, Shkodër, për automjetin me targa AA 305 AE, në shumën 122.500 lekë.
- Faturë dalje datë 25.09.2020 nga servis "VELIJA", Bërdicë, Shkodër për shërbimin e kryer për automjetin me targa AA 305 AE, në shumën 205.500 lekë.
- Kontratë shitblerje me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 04.12.2012, për blerjen e automjetit tip Opel Corsa, me targa AA 420 EV, me palë shitëse A. A. dhe palë blerëse Suela Meta, në vlerën 3.500 euro.
- Leje qarkullimi datë 08.02.2024, për automjetin tip Opel, në emrin e bashkëshortes Suela Meta;
- Deklaratë noteriale me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 08.02.2024, ku, shtetasi A. Rr. deklaron se: "Në muajin mars 2020 kam blerë nga znj. Suela Meta një mjet autoveturë, marka Opel, me targa AA420EV, në shumën 3.500 euro. Duke qenë se mjete nuk ishte kaluar në pronësi të zonjës Suela Meta por kishte vetëm kontratën e shitblerjes me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 04.12.2012, në pritje të kalimit të pronësisë nuk kemi nënshkruar kontratë shitblerje. Sot, më datë 08.02.2024, pasi kaloi mjete në emrin e saj, me nr. leje qarkullimi TRF 02076624, datë 08.02.2024, duke qenë se kishte difekte të riparueshme, kërkua regjistrimin e përhershëm nga qarkullimi Bashkëlidhur: Leje Drejtimi e shtetasit A. Rr.
- Vërtetim Nr. TRF 0207882, datë 08.02.2024, nga DRSHTRR Tiranë, për heqjen e përhershme nga qarkullimi të mjetit Opel, me targa AA420EV. .

1.9. Bazuar në deklarinimin e subjektit dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Automjete tip Mercedes Benz GLK, me targa AB 305 AE, në bashkëpronësi të bashkëshortes Suela Meta me motrën e saj B. D. është blerë në vitin 2020, në vlerën 6.080 euro (pjesa takuese 3.040 euro), dhe është shitur në maj 2023, në vlerën 12.000 euro, për arsye se, pasi janë kryer shërbime, mjete është bërë në gjendje shumë të mirë teknike dhe strukturore.

- 1.10. Burimi i blerjes së tij janë deklaruar të ardhurat nga shitja e automjetit tip Opel Corsa në vitin 2020 në vlerën 3.500 euro, pa kontratë shitblerje. Trupa Vlerësuese nuk i ka marrë parasysh të ardhurat nga shitja e mjetit, i cili nuk figuronte i regjistruar në pronësi të Suela Metës dhe nuk është shitur me kontratë shitblerje, por nga analiza financiare e kryer ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë patur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie nga kursimet familjare. Ky automjet (tip Opel Corsa me targa AA 420 EV) është blerë në v. 2012, në vlerën 3.500 euro, (paraqitur kontrata), me burim kursime familjare nga pagat dhe të ardhura nga shitja e automjetit tip Volksëagen Polo, me targa TR 2880 T, në muajin nëntor 2012, në vlerën 1.000 euro.
- 1.11. DPSHTRR konfirmon mjetin tip Mercedes Benz, me targa AB305AE, në bashkëpronësi të bashkëshortes së subjektit, Suela Meta, me motrën e saj. Ky automjet është shitur në datë 09.05.2023, pas datës së dorëzimit të deklaratës së vlerësimit kalimtar. Shpenzimet për riparimin e mjetit tip Mercedes Benz, me targa AB305AE, në vitin 2020, janë dokumentuar në shumën rreth 328.000 lekë (pjesa takuese e b/shortes 164.000 lekë). Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me burimin e blerjes së automjetit.
- 1.12. DPSHTRR me shkresë me nr. ** prot.,18.09.2024, konfirmon se Suela Meta ka pasur të regjistruar automjetin tip Volkswagen Polo, me targa TR 2880 T, me nr. shasie xxxxxxxxxxxx, blerë me kontratë shitblerje me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 02.03.2012, me palë shitëse shtetasen I. A., në vlerën 3.000 euro, vlerë e paguar jashtë zyrës noteriale. Suela Meta me kontratë shitblerje me nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 13.10.2015, ka shitur automjetin tip Volkswagen Polo, me targa AA 307 EA (ish targa TR 2880 T), me palë blerëse N. D., në vlerën 1.000 euro, vlerë e paguar para redaktimit të kontratës jashtë zyrës noteriale.
- 1.13. Në proces verbalin e datës 13.02.2024 subjekti sqaroi se automjetin tip Volkswagen Polo me targa AA 307 EA, bashkëshortja Suela Meta e ka blerë në datë 02.03.2012, në vlerën 3.000 euro dhe e ka shitur në fund të muajit nëntor 2012, ndaj shtetasit N. D., në vlerën 1.000 euro, i cili ishte punonjës policie dhe kolegu i subjektit, pasi punonim bashkë në Drejtorinë e Policisë Durrës. Në momentin e shitjes së këtij mjeti dhe likuidimit të vlerës së shitjes, për shkak të marrëdhënieve shoqërore, nuk kanë kryer kontratë shitblerje. PAGESA e vlerës 1.000 euro nga shtetasi N. D. është bërë në cash. Meqenëse ky shtetas u transferua me detyrë në qytetin e Pogradecit dhe më pas në vitin 2013 është larguar nga puna në polici, për një kohë të gjatë nuk kanë kontaktuar dhe nuk kanë bërë kontratën e shitjes së mjetit Volkswagen Polo. Për efekt dokumenti dhe për të qenë në rregull me pronësinë e këtij mjeti, i 'u kërkua shtetasit N. D. nënshkrimi i kontratës së shitjes së mjetit, e cila është bërë në datë 13.10.2015, shumë kohë, pasi mjetin e kishin shitur dhe ishte bërë likuidimi vlerës. Burimi i krijimit për blerjen e automjetit Volkswagen Polo, me targa AA 307 EA, janë kursimet familjare nga pagat në ato vite, të cilat janë kredituar në sistemin bankar. PAGESA e blerjes së mjetit tip Volkswagwen Polo e është bërë cash jashtë sistemit bankar ndaj shtetasit I. A.
- 1.14. Deklarimi i vlerës së blerjes së këtij mjeti në deklaratat e interesave privatë ndër vite, në shumën 2.000 euro, është lapsus nga subjekti. Të ardhurat nga shitja e automjetit tip Volkswagen Polo, në muajin nëntor 2012, në vlerën 1.000 euro, janë përdorur në muajin dhjetor të viti 2012, për blerjen e automjetit Opel Corsa. Mosdeklarimi i shitjes së automjetit tip Volkswagen Polo, me targa AA 307 EA, në deklaratat e interesave privatë

ndër vite është harresë, pasi nuk kishte bërë kontratën e shitjes. Subjekti ka kërkuar të kontaktoj me ish kolegun N. D., të cilit i ka shitur automjetin tip Volksëagen, në muajin nëntor 2012, për ti marrë deklaratë lidhur me periudhën kur i 'a ka shitur këtë automjetin, pavarësisht se kontratën e shitjes e kanë kryer në vitin 2015, por nuk ka mundur të kontaktoj.

1.15. Bazuar në deklarinimin e subjektit, në përgjigjet e pyetjeve të ribëra nga Trupa mbi këtë çështje, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI në mënyrë të përmbledhur rezulton se Automjeti tip Volkswagen Polo, me targa AA307EA, në pronësi të bashkëshortes së subjektit, është blerë dhe shitur brenda vitit 2012, përkatësisht me vlerë blerje 3.000 euro dhe vlerë shitje 1.000 euro, me burim të ardhurat nga pagat.

- ✓ **Konfirmohet automjeti i tjetërsuar tip Volkswagen me targa LA8659A, me përgjigjen e DPSHTRR.**
- ✓ **Subjekti ka sqaruar se të ardhurat nga shitja e automjetit tip Volkswagen, me targa LA 8659 A, janë përfituar në muajin nëntor 2012.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë me kursime familjare.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

Të ardhura nga paga nga viti 2005 deri në vitin 2022, të ndara sipas bankave, ka qenë:

Banka Raiffeisen për vitet 2005 - 2006 - 2007 - 2008 - 2009 - 2012 - 2013 - 2014 - 2015 - 2016, me shumë totale 2.836.036 lekë;

Banka BKT për vitet 2016 - 2018, me shumë totale 1.140.040 lekë;

Banka Credit Agricol, për disa muaj në vitin 2013, me shumë totale 1.140.040 lekë; Banka ALPHA, me shumë totale 707.495 lekë;

Banka BKT për vitet 2018 deri në shkurt 2023, me shumë totale 2.998.265 lekë. Shuma totale në gjithë vitet: 7.995.244 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Dokument i përgatitur, dorëzuar nga subjekti, që konfirmon se pagat e bashkëshortes Suela Meta në Raiffeisen Bank, për periudhën e viteve 2005 - 2016, janë në shumën 2.836.037 lekë.
- Dokument i përgatitur, dorëzuar nga subjekti, që konfirmon se pagat e bashkëshortes Suela Meta, në BKT, për periudhën e viteve 2016 - 2018, janë në shumën 1.140.040 lekë.
- Dokument i përgatitur, dorëzuar nga subjekti, që konfirmon se, pagat e bashkëshortes Suela Meta, në Alpha Bank, për periudhën e viteve 2009 - 2012, janë në shumën 707.097 lekë.
- Dokument i përgatitur, dorëzuar nga subjekti, që konfirmon se, pagat e bashkëshortes Suela Meta në Credit Agricol për disa muaj në vitin 2013, janë në shumën 313.408 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga BKT, datë 07.03.2023, që konfirmon se Suela Meta ka llogari page dhe për periudhën 02.03.2018 - 02.03.2023 i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat dhe shpërblime nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe ISHTI, në shumën rreth 3.125.107 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. Raiffeisen Bank, me shkresë me nr. ** prot., datë 04.09.2023, konfirmon se Suela Meta ka pasur llogari page dhe për periudhën 18.04.2005 - 02.11.2009; 02.11.2012-01.03.2013 dhe 01.11.2013 - 03.10.2016 i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga paga, dietat, honorare, shpërblime, trajnime, etj, në shumën rreth 2.587.037 lekë.
2. BKT me shkresë me nr. ** prot., datë 13.09.2023, që konfirmon se Suela Meta ka llogari page dhe për periudhën 01.11.2016 - 02.03.2023 i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat dhe shpërblime nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe ISHTI, në shumën rreth 4.115.449 lekë.
3. OTP Bank me shkresë me nr. ** prot., datë 04.09.2023, konfirmon se Suela Meta ka patur llogari bankare pranë OTP Bank Albania Sha (duke qenë se Alpha Bank është përthithur nga OTP Bank, duke filluar nga data 01.12.2022, banka ka dhënë informacion edhe mbi llogaritë që klienti ka patur në dy sistemet bankare). Për periudhën 28.12.2009 -01.10.2012, në llogari i janë kredituar të ardhura nga pagat e kompanisë në shumën rreth 707.097 lekë.
4. ISSH me shkresë me nr. ** prot., datë 06.09.2023, konfirmon se, Suela Meta për periudhën janar 2012 - mars 2023 ka përfituruar të ardhura neto nga pagat nga Reli Konstruksion, Agjencia Kombëtare Planifikimit të Territorit, dhe Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
5. Në proces verbalin e datës 13.02.2024, subjekti sqaroi se gjatë periudhës 01.01.2013 - 31.12.2013, bashkëshortja Suela Meta ka punuar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit. Gjithashtu, sqaroi se, gjatë periudhës prill 2005 - tetor 2009, bashkëshortja Suela Meta është trajtuar me pagesë kalimtare nga Komisarjati i Policisë Sarandë, Drejtorja Vendore e Policisë Gjirokastër dhe Drejtorja Vendore e Policisë Korçë dhe këto të ardhura i kanë kaluar në llogarinë e saj pranë Raiffeisen Bank, të cilat evidentohen edhe nga përlllogaritja që kishte bërë bashkëshortja e tij.

Paraqiti:

- Vërtetim punësimi nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, me nr. ** prot., datë 22.01.2024, që konfirmon se znj. Suela Meta për periudhën janar 2013 - dhjetor 2013, të ardhurat mujore i kanë kaluar respektivisht: Për periudhën janar - shkurt 2013 në Raiffeisen Bank; Për periudhën mars - shtator 2013 në Bankën Credit Agricole; Për periudhën tetor - dhjetor 2013 në Raiffeisen Bank.
- Vërtetim i të ardhurave nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit që konfirmon se znj. Suela Meta për periudhën nga 01.01.2013 deri në 31.12.2013, ka përfituruar të ardhura nga paga neto në shumën 539.021 lekë.
- Konstatohet se për muajt mars - shtator 2013 të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, të kredituara në Bankën Credit Agricole, janë rreth 313.408 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga ISSH, punëdhënës Komisarjati i Policisë Sarandë, që konfirmon të ardhurat e përfitura nga Suela Meta për periudhën 2005 deri në 31.11.2006.
- Vërtetim page me nr. ** prot., datë 18.01.2024, nga Drejtorja Vendore e Policisë Gjirokastër që konfirmon të ardhurat e përfitura nga Suela Meta për periudhën 05.12.2006 - 10.07.2007.
- Komisarjati i Policisë Korçë, që konfirmon të ardhurat e përfituara nga Suela Meta për periudhën 05.11.2007 deri në 3.10.2009.

6. Të ardhurat neto të bashkëshortes të subjektit për periudhën prill 2005 - mars 2023, të dokumentuara, janë rreth 7.710.566 lekë.

DETYRIMET FINANCIARE

- Nuk kam.

DEKLARIMI I DJALIT - ENEID META

DEKLARIMI I PASURIVE

- Nuk kam

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Nuk kam.

ISSH me shkresë nr. 66/30 prot., datë 06.09.2023, konfirmon se Eneid Meta nuk ka përfituar të ardhura nga pagat.

DETYRIMET FINANCIARE

- Nuk kam.

Gjetje të tjera:

- Banka e Shqipërisë, Intesa Sanpaolo Bank, Tirana Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, Banka e Parë e Investimeve, Banka Amerikane e Investimeve, Credins Bank, Union Bank, Raiffeisen Leasing, Porche Leasing, Albania Leasing, Landesleasing, Raiffeisen Invest, Credins Invest, Unioni Financiar i Tiranës, Easypay, Fondi Besa, Insitucioni Financiar NOA, Iute Credit Albania Kredo Financë, konfirmojnë se subjekti Lorenc Meta, dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, cka konfirmohet me deklarinimin.
- Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Librazhd Mallakastër, Fier, Gjirokastrë, Devoll, Lushnjë, Korçë, Berat, Pogradec, Kukës, Kavajë, Gramsh, Malësi e Madhe, Kucovë, Kamëz Vorë, Pukë, Peqin, Skrapar, Bulqizë, Has, Kolonjë, Elbasan, Mirditë, Tropojë, Tepelenë, Përmet, Mat, Shkodër, Sarandë, Krujë, Dibër, Lezhë, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.
- Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 04.09.2023, konfirmon se Lorenc Meta ka llogari page me gjendje në datë 10.03.2023, **në shumën 549.611 lekë**. Në

datë 21.12.2007 i është kredituar në llogari shuma 250.000 lekë nga shtetasja T. H. dhe në datë 24.12.2007, Lorenc Meta ka tërhequr shumën 250.000 lekë.

- Lorenc Meta ka llogari rrjedhëse në euro, me gjendje në datë 10.03.2023, në shumën **174 euro**. Në datë 11.11.2020 Lorenc Meta ka derdhur në llogari shumën 3.000 euro dhe ka transferuar shumën 2.826 euro për Azienda Ospitali Era Universi (pagesë shërbimi spitalor).
- Suela Meta ka pasur llogari page dhe në datat 17.06.2015, 01.07.2015 shtetasi L. S. ka derdhur në llogari shumën totale 200.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës

- Vërtetim datë 03.02.2023 nga Raiffeisen Bank, që konfirmon se Lorenc Lulzim Meta, me nr. klienti xxxx, ka llogari rrjedhëse në lekë me gjendje në fillim vitit 2023, në shumën 682.382 lekë.
- Në proces verbalin e datës 13.02.2024. subjekti sqaroi se gjendjen e llogarisë së pagës në Raiffeisen Bank e ka deklaruar në deklaratat e interesave private të vitit 2022. *Mosdeklarimi i kësaj gjendje llogarie në deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar në muajt mars 2023 është harresë në deklarim. Nuk ka pasur qëllim për të mos e deklaruar gjendjen e llogarisë së pagës në Raiffeisen Bank, pasi ajo ishte lehtësisht e verifikueshme në sistemin bankar.*
- Kreditimi në datë 21.12.2007 në Raiffeisen Bank është kryer nga shtetasja T. H., e cila është tezja e subjektit, motra e nënës Dylbere Meta, e cila jetonte dhe punonte në atë periudhë bashkë me bashkëshortin e saj të ndjerë, I. H., si emigrantë në Belgjikë. Në atë periudhë ajo kishte ardhur në Shqipëri dhe meqenëse subjekti ishte punonjës policie, kishte nevojë të përkujdesej për djalin e saj E. H., i cili jetonte në atë kohë në Shqipëri dhe ishte nxënës në gjimnazin publik Mamuras - Kurbin. Pas marrëveshjes verbale me tezen e tij dhe për arsye se ajo dhe bashkëshorti i saj jetonin dhe punonin në Belgjikë, derdhi në llogarinë e subjektit shumën 250.000 lekë, në datë 21.12.2007, me qëllim që t'i jepeshin djalit të saj Elson Hasani, gradualisht, në shuma të vogla, për nevoja dhe shpenzime të ndryshme dhe jo menjëherë, pasi ai mund ti shpenzonte shumë shpejt. Shumën 250.000 lekë, shtetasja Trendafile Hasani (tezja e subjektit), e kaloi në llogarinë e subjektit në Raiffeisen Bank, me kërkesën e tij, për të mos krijuar keqkuptime. Më pas, subjekti ka tërhequr vlerën 250.000 lekë dhe ka vepruar sipas udhëzimit të saj.
- Kreditimi i shumës 3.000 euro, në datë 11.11.2020, në Raiffeisen Bank dhe transferimi i shumës 2.826 euro për Azienda Ospitali Era Universi (pagesë shërbimi spitalor) është bërë pasi në vitin 2020 subjekti është diagnostikuar me një sëmundje të rëndë në veshka, gjë e cila kërkonte analiza dhe ndërhyrje në një spital të specializuar në një kohë sa më të shpejtë. Për shkak periudhës së Covidi 19, cdo

institucion shtetëror ishte i mbyllur fizikisht dhe nuk e kishte te mundur të kërkonte ndihmë për ta dërguar subjektin në një spital të specializuar jashtë shtetit. Pas diagnostikimit dhe pamundësisë për të marrë ndihmë nga institucionet në Shqipëri, ka njoftuar motrën e tij, A. G., me banim në Firenze - Itali, duke i dërguar informacionin lidhur me problemet shëndetësore që kishin konstatuar. Ajo është interesuar në Spitalin Azienda Ospedaliero Universitaria Careggi, Firenze Itali, e cila pasi bëri verifikimet, dërgoi preventivin për sëmundjen dhe gjithë procedurat që duhej të ndiqte në këtë spital. Vlera totale sipas preventivit ishte 3.846 euro dhe për këtë arsye në datë 11.11.2020, subjekti ka derdhur në llogarinë në Raiffeisen Bank shumën 3.000 euro, me burim kursime nga të ardhurat familjare, të cilat i ka poseduar në gjendje cash dhe në 13.11.2020 ka transferuar për llogari të spitalit shumën 2.826 euro. Në datë 13.11.2020 është nisur në Firenze, Itali, dhe është shtruar në Spitalin Azienda Ospedaliero Universitaria Careggi, ku ka qëndruar deri në datë 03.12.2020. Sqaroi se, në llogarinë e spitalit në Intesa SanPaolo Bank, Itali, ka transferuar pagesën shtesë të shërbimit spitalor në shumën 1.020 euro.

- Shtetasi L. S., i cili ka transferuar shumën totale 200.000 lekë në llogarinë e bashkëshortes së subjektit, Suela Meta, në Raiffeisen Bank, në datat 17.06.2015 dhe 01.07.2015, është kushëriri i subjektit me të cilin janë rritur në lagje në Mamurras Kurbin. Ky shtetas jeton dhe punon nga viti 2013 në Romë Itali dhe në Shqipëri kishte vetëm prindërit. Në atë kohë ishte në Shqipëri dhe po ndërtonte shtëpinë e tij në lagjen Drita, Mamurras, Kurbin. Gjatë kësaj periudhe, derdhi në llogarinë e bashkëshortes së subjektit Suela Meta, shumën 200.000 lekë, me burim të ardhura nga puna në emigracion në Itali, me qëllim pagesa të ndryshme për punimet në shtëpinë e tij, blerje materialesh etj, pasi ai do largohej përsëri për në Romë, Itali. Në atë kohe, subjekti punonte në Drejtorinë e Policisë Berat dhe nuk kishte mundësi të bënte këto pagesa.

Paraqiti:

- Deklaratë (e panoterizuar) nga shtetasja T. H., e cila deklaroi se: "Në muajin dhjetor 2007, meqenëse isha në emigracion të parregullt dhe nuk mund të lëvizja shpesh në Shqipëri, i kam hedhur në bankë 250.000 lekë, djalit të motrës time, Lorenc Meta. Këtë shumë e ka kredituar në llogarinë e Lorenc Meta, për t'ia dhënë djalit tim, E. H., që në atë kohë unë e kisha në Shqipëri në një periudhë të zgjatur, pasi ai ishte i mitur dhe nuk mund ti menaxhonte dot këto lekë. Unë ia kam dhënë Lorencit këtë shumë, pasi duke qenë se ai ishte punonjës policie, im bir e dëgjonte më shumë se familjarët e tjerë. Kjo shumë është hedhur nëpërmjet sistemit bankar, me kërkesë të Lorencit, me qëllim që mos të kemi ndonjë keqkuptim me djalin tim. Meqenëse unë jam përsëri në Belgjikë dhe nuk kam mundësi lëvizje, këtë deklaratë e kam dërguar pa kaluar nëpërmjet noterit." Bashkëlidhur, kopje e pasaportës së T. H., me nr ID Gxxxxxxx; Certifikatë familjare, datë 08.02.2024, nga Rrethi Kurbin, Arkiva Mamurras, referuar gjendjes civile të vitit 1950 - 1974, që konfirmon se T. Cakani është motër me nënën time Dylbere Cakani.

- Dokumentin nga Spitali Azienda Ospedaliero Universitaria Careggi, datë 21.10.2020, që konfirmon shtrimin në spital të Lorenc Meta dhe procedurat e shpenzimeve spitalore në shumë totale 3.846 euro. Bashkëlidhur: kopje pasaporte e Lorenc Meta me nr. ID 101123044 E, si dhe dokument nga Intesa SanPaolo Bank Itali.
- Deklaratë nga shtetasi Liridon Sulaj, i datëlindjes 9.12.1992, lindur në Mamurras dhe banues në Romë, i cili deklaroi se: "Në vitin 2015 kam hedhur në llogarinë bankare të Suela Meta dy herë shumën nga 100.000 lekë. Këto lekë unë i kam hedhur në atë llogari pasi duke qenë se isha me punë dhe banim jashtë Shqipërisë nuk kisha mundësi bëja disa pagesa për shtëpinë time që po ndërtoja në Mamurras. Këto pagesa ishin për ustallarët dhe punëtorët që punonin aty, si dhe për materialet që mund duheshin, si cimentim, etj. Këto lekë i kreditova në llogarinë e Suela Meta dhe jo Lorencit, të cilin e kam kushëri timin dhe shumë të afërt në marrëdhënie familjare, pasi ai ishte me punë larg Tiranës dhe nuk kishte mundësi të bënte këto pagesa kur duheshin ". Bashkëlidhur: Kopje e pasaportës së L. S., me nr ID JxxxxxQ; Karte Identiteti me nr. AXxxxx, nga shteti Italian e L. S.
- Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me transaksionet e konfirmuara në RFZ Bank nga të afërm të tij dhe për llogari të tyre.
- Subjekti nuk ka deklaruar gjendjen e mbetur në llogarinë e pagës në RFZ Bank. në datë 10.03.2023, në shumën 549.611 lekë, por i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, vërtetim nga RFZ Bank, që konfirmon gjendjen e llogarisë në fillim të vitit 2023.
- Gjithashtu ka dokumentuar shpenzime shëndetësore në vitin 2020, në shumën rreth 3.850 Euro. BKT, me shkresë me nr. ** prot., datë 13.09.2023, konfirmon se Lorenc Meta ka pasur llogari kartë krediti në lekë. Në datë 23.12.2014 ka kredituar shumën 3.000 lekë, të cilën e ka konvertuar në euro dhe transferuar në llogarinë e kartës së kreditit në euro.
- BKT, me shkresë me nr. ** prot., datë 03.09.2024, konfirmon se Lorenc Meta ka kryer me kartën e kreditit veprime të pasqyruara nga viti 2014 deri në vitin 2019. Nga administrimi i dokumentacionit përkatës Trupa Vlerësuese nuk konstatoi ndonjë veprim që të ngjallte dyshime.
- Suela Meta, ka pasur llogari rrjedhëse në euro me gjendje 0. Në llogari nuk janë kryer kreditime.
- Subjektit i është kërkuar të sqarojë disa pagesa mujore që ka kryer bashkëshortja nga BKT për llogari të FSHU, ku përveç likuidimit të detyrimit për kontaktin në emër të tyre, rezultojnë dhe pagesa për dy kontrata të tjera me nr. Abonenti BU0Exxxxxx dhe BU0Exxxxxx.
- Subjekti ka sqaruar se abonentët e lartpërmendur janë babai dhe vjehri i tij, dhe meqenëse ata janë pensionistë kemi ndjerë detyrimin që herë pas here t`ju paguajmë energjinë elektrike, duke i vlerësuar nga ana njerëzore prindërit tanë.

- U administrua dokumentacioni përkatës ku konfirmohet deklarimi i subjektit për dy kontratat e energjisë dhe u shtuan si shpenzime në pasqyrën e analizës financiare të subjektit dhe personave të lidhur me të.
- AK Invest, me shkresë me nr. ** prot., datë 07.09.2023, konfirmon se shtetasit: Lorenc Meta, i dtl. 23.11.1980, nuk ka kryer transferta monetare nëpërmjet rrjetit të Ak-Invest Sha, Suela Meta, dtl. 23.08.1981, nuk ka kryer transferta monetare nëpërmjet Ak-Invest Sha, Eneid Meta, datëlindja 12.09.2004, nuk ka kryer transferta monetare nëpërmjet Ak-Invest Sha, Lorela Meta, dtl. 31.03.2008, nuk ka kryer transferta monetare nëpërmjet Ak-Invest Sha, Erkanda Meta, datëlindja 06.01.2014, nuk ka kryer transferta monetare nëpërmjet Ak-Invest Sha.
- Nga një kërkim i detajuar i transaksioneve, rezulton se një shtetas me emrin Lorenc Meta për të cilin nuk disponohen të dhëna për të vërtetuar gjeneralitetin e tij, ka kryer 3(tre) transferta monetare si përfitues, si më poshtë vijon: Tipi i transaksionit: Tërheqje; Data e transfertës: 06.09.2011; Shuma: 230 euro; Emri i marrësit Lorenc Meta (AL); Emri i dërguesit: Sh. Meta (Itali); - Tipi i transaksionit: Tërheqje; Data e transfertës: 04.12.2011; Shuma: 150 euro; Emri i marrësit Lorenc Meta (AL); Emri i dërguesit: Sh. Meta (Itali); Tipi i transaksionit: Tërheqje; Data e transfertës: 30.12.2013; Shuma: 31.200 lekë; Emri i marrësit Lorenc Meta (AL); Emri i dërguesit: S. D. (GB).
- Në proces verbalin e datës 13.02.2024, lidhur me konstatimin nga AK Invest, deklaroi se Lorenc Lulzim Meta, i datëlindjes 23.11.1980, nuk ka kryer transferta parash nëpërmjet këtij institucioni.
Paraqiti:
 - Vërtetim me nr. ** prot., datë 18.01.2024, që konfirmon se Lorenc Lulzim Meta, i datëlindjes 23.11.1980, nuk ka kryer transaksione nëpërmjet rrjetit të këtij institucioni.
 - Subjekti dha sqarime lidhur me konstatimin nga AK - Invest.
 - QKB, me shkresë nr. ** prot., datë 04.09.2023, konfirmon se për periudhën deri më 10.03.2023, shtetasi Lorenc Meta dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT), si persona fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruar pranë regjistrit tregtar.
 - DPT, me shkresën nr. ** prot., datë 08.09.2023, konfirmon se shtetasi Lorenc Meta dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.
 - Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. ** prot., datë 20.09.2023, nuk konfirmon mjete lundruese në pronësi të shtetasit Lorenc Meta dhe familjarëve të tij.
- *Nga verifikimi i veprimeve noteriale, u konstatua se me aktin noterial nr. ** Rep., dhe nr. ** Kol., datë 01.10.2012, subjekti ka lidhur një kontratë sipërmarrje për shitje ndërtimi për një apartament 68 m2 në lagjen nr.13, plazh, tek Shkëmbi i Kavajës Durrës, ku cmimi që porositësi do ti paguajë ndërtuesit është 29240 euro. Sipas marrëveshjes mes palëve ky cmim është likuajduar totalisht jashtë zyrës noteriale.*
- *Në lidhje me këtë fakt subjektit iu kërkuan sqarime për krijimin e kësaj pasurie, mosdeklarimin e saj si dhe burimin e krijimit.*

- Në përgjigjet e subjektit nr. ** prot., datë 12.09.2024, trupa ka administruar deklaratën noteriale nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë 31.12.2016, mbi revokimin e plotë të aktit nr. ** rep., nr. ** kol., datë 01.10.2012.
- Subjekti ka sqaruar se: “Në lidhje me kontratën e sipërmarrjes kam patur shumë problematika me firmën dhe rreth një muaj më pas i kam prishur marrëdhëniet dhe më janë kthyer pagesat mbrapsht. Më pas firma u bllokua dhe i hyri kalvarit të drejtësisë dhe me zhbllokimin nga drejtësia kemi bërë ligjërisht me akt notarial revokimin e plotë të kontratës së sipërmarrjes. Duke qenë se këto veprime nuk kanë patur asnjë shtim apo pakësim të aseteve të mia, nuk është parë e arsyeshme nga ana ime të bëhej një deklaram për këtë pasuri.”
- Gjithashtu në lidhje me pyetjen e burimit të krijimit, subjekti në përgjigjet e kthyer me shkresë nr. ** prot., datë 04.10.2024, ka sqaruar se: “Në përgjegjësinë time të plotë deklaroj se nuk është bërë pagesa e shumës 29240 euro, sikurse është shprehur në kontratë, kjo gjë u vendos me mirëkuptim të palëve. Unë kam paguar dy këste paraprake nga 1000 euro përkatësisht datë 20.09.2012 dhe datë 01.10.2012. Pas mosmarrëveshjeve mu kthye shuma prej 2000 eurove, datë 29.11.2012.”
- Subjekti ka paraqitur dokumentacion shoqërues justifikues duke vënë në dispozicion të Trupës Vlerësuese mandatet përkatëse të veprimeve më lart.

✓ ***Në konkluzion për vlerësimin e pasurisë, në përputhje me pikën 6 të nenit 34 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:***

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe se punonjësi nuk gjendet në situatë konflikti interesi;***
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;***
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;***
- ç) nuk është kryer deklarim i rremë;***
- d) punonjësi nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.***

Analiza financiare e subjektit dhe personave të lidhur me të

Burimi/Viti	2002-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	TOTALI
Të ardhura neto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit	619,358	737,246	505,313	509,769	555,740	803,248	1,026,416	1,235,981	954,838	1,003,134	1,120,546	1,059,447	1,147,541	917,722	1,029,372	997,757	1,115,631	1,114,550	1,159,904	1,377,119	319,145	19,309,777
Të ardhura neto nga paga për bashkeshorten			83,506	121,093	127,515	172,009	166,241	251,232	251,232	332,366	538,353	464,210	607,059	576,635	744,462	898,036	903,381	93,987	407,714	760,396	211,139	7,710,566
Të ardhura neto nga interesat bankarë																						-
Të ardhura te krijuara nga shitja e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme																						-
Të ardhura te krijuara nga investimi ne tituj																						-
Te hyra nga dhurimet																						-
Totali i të Ardhurave dhe të hyrat	619,358	737,246	588,819	630,862	683,255	975,257	1,192,657	1,487,213	1,206,070	1,335,500	1,658,899	1,523,657	1,754,600	1,494,357	1,773,834	1,895,793	2,019,012	1,208,537	1,567,618	2,137,515	530,284	27,020,343
Detyrime: Te hyra nga huatë/kredit																						-
Shpenzime jetike sipas INSTAT	187,224	280,836	332,136	332,136	707,184	546,480	853,008	853,008	853,008	558,192	558,192	959,065	985,919	1,036,255	992,933	1,060,332	1,140,672	1,195,908	1,214,676	1,289,268	250,333	16,186,765
Shpenzime-humbje nga shitja e pas.luajtsh.													279,920									279,920
Shpenzime për Mjekim																		636,715				636,715
Shpenzime për Arsimimin				246,440	244,780	246,260		316,780	396,600	115,000	75,000	150,000	150,000	150,000	150,000	150,000	186,050	577,800	629,258	648,968	50,105	4,483,041
Shpenzime Udhëtimi jashte vendit																		54,945	282,921	504,290	36,132	878,289
Shpenzime E.E. per babain dhe vjehrin																			14,804	62,463	17,843	95,110
Shpenzime dhe te dala te tjera-mobilimi						238,500	238,500															477,000
Totali i shpenzimeve dhe te dalave	187,224	280,836	332,136	578,576	951,964	1,031,240	1,091,508	1,169,788	1,249,608	673,192	633,192	1,109,065	1,415,839	1,186,255	1,142,933	1,210,332	1,326,722	2,465,368	2,141,659	2,504,989	354,413	23,036,838
Investime.pasuri-motorr road king+benz GLK																		658,176				658,176
Investime-merc.benz+opel corsa+wolswagen						735,000				909,215			909,215									735,000
Lik. ALL L.Meta-RFZ Bank- llog.paga			13,973	789	44,578	2,853	52,739	37,049	21,743	4,266	46,470	24,525	34,245	10,714	3,543	1,776	77,936	317,982	143,181	420,093	132,771	549,610
Lik. ALL L. Meta-Euro-RFZ Bank																		371,190	349,661			21,529
Lik. ALL S. Meta-RFZ Bank- llog.paga			4,317	9,016	1,016	7,491	2,532	374		6,456	1,263	1,339	3,165	35								-
Lik. ALL S.Meta-BKT Bank- llog.paga														967	844	3,009	5,380	8,512	25,661	7910	41,295	74,866
Lik. ALL L.Meta-BKT Bank-llog.karte krediti												3,000	3,000									-
Lik. ALL L.Meta-BKT Bank-llog.euro																						-
Lik. ALL S.Meta-OTP Bank- llog.paga							16,209	8,232	2,347	24,202	2,944					414	-56					-
Gjendje Cash (ndryshimi: shtim /pakesim)																						-
Totali Pasuri	-	-	18,290	8,227	43,562	730,362	33,998	29,191	24,090	874,291	48,151	28,864	881,135	11,716	4,387	5,199	83,260	1,338,836	467,181	428,003	91,476	2,039,181
Mundesia per Kursime : Ardhura+Detyrime-Shpenzime-Pasuri.	432,134	888,544	1,126,937	1,170,996	858,725	72,380	207,527	554,143	486,515	274,532	1,348,390	1,734,118	2,954,014	3,250,400	3,885,688	4,565,950	5,174,980	2,579,314	2,472,454	1,676,977	1,944,324	

B. KONTROLLI I FIGURËS:

1. Objekti i kontrollit të figurës, sipas nenit 35 të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar është verifikimi i deklaramëve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklaramëve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
2. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, e kryer nga Trupa Vlerësuese është mbështetur në katër elementë:
 - (i) të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e kontrollit të figurës, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 1, Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - (ii) raporti i hollësishëm dhe i arsyetuar i strukturës përgjegjëse pranë AMP-së sipas përcaktimeve të Nenit 42, pika 1 e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - (iii) të dhënat e mbledhura nga Trupa e Vlerësimit, në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 3, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - (iv) verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të Nenit 36, pika 3, gërma (ë), e Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
3. Subjekti Lorenc Meta ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në zbatim të Nenit 36, pika 1 e Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar.
4. Në Raportin mbi Kontrollin e Figurës për subjektin e vlerësimit nr. ** prot., datë 19.12.2023, përgatitur nga AMP, trupa është informuar se subjekti i vlerësimit Lorenc Meta është i përshatshëm për vazhdimin e detyrës.
5. Në *Deklaratën për Kontrollin e Figurës¹, Subjekti i vlerësimit, Lorenc Meta, nuk ka raportuar ndonjë të dhënë për të cilën duhej të fillonte verifikimi i thelluar sipas kritereve dhe kushteve të ligjit nr.138/2015 dhe në zbatim të detyrimit të ligjit të posaçëm nr. 12/2018, i ndryshuar.*

1

- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka të regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka patur shtetësi tjetër.
- Nuk është dënuar ndonjëherë më vendim gjyqësor të formës të prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk është ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë penale.
- Nuk ka patur urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë ndonjëherë masa e dëbimit nga një shtet i huaj.
- Nuk është në dënim të përfshirjes së ndonjë nga anëtarët e familjes në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka patur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi të qëllimshëm, me një ose shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës.
- Nuk ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë ushtrimit të detyrës.
- Nuk është në dënim të anëtarët e familjes kanë patur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk është në dënim të anëtarët e familjes të ketë pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Gjatë 10 viteve të fundit, nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrajnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keqprezantuar, falsifikuar, një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të vecantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të pa autorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar ndonjëherë azil politik.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka varësi nga alkoli dhe lojrat e fatit.
- Nuk ka vuajtur nga crregullime mendore kronike.
- Nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991 sipas ligjit "Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

6. Për të kontrolluar figurën dhe saktësinë e deklaramit për subjektin e vlerësimit, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna me anë të korrespondencës pranë këtyre institucioneve:

✚ **AKSIK**

✚ **SHISH**

✚ **AMP**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**

✚ **Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Gjyqësore**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**

✚ **Avokati i Popullit**

✚ **AISM**

✚ **Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK)**

✚ **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**

✚ **AIF**

7. Procedura për kontrollin e figurës është kryer sipas përcaktimeve të Nenit 36-37 të ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” të ndryshuar, bazuar në kontrollin e deklaramit dhe marrjes së informacionit apo materialeve të tjera nga institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, duke i vlerësuar ato bazuar në dispozitat e neneve 38 - 41 të Ligjit nr.12/2018 të ndryshuar.

8. Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, ka rezultuar se:

✓ Subjekti i vlerësimit është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”, me datë lëshimi 25.01.2023, të vlefshme deri në datë 24.01.2028.

Nga AKSIK nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm CSP. AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

✓ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën e saj bën me dije se për subjektin e vlerësimit Lorenc Lulzim Meta, nuk ka ndryshuar apo marrë shtetësi tjetër, nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit.

✓ Nuk ka patur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht nga Avokati i Popullit, konfirmuar me shkresë.

✓ Nuk ka denoncime nga publiku në faqen zyrtare të AMP dhe nuk disponohen ankesa për subjektin e vlerësimit.

✓ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, konfirmon se shtetasit Lorenc Lulzim Meta, Suela kamer Meta dhe Eneid Lorenc Meta, nuk rezultojnë të dënuar.

✓ Institucioni ligjzbatues dërgon informacion se për subjektin e vlerësimit disponon të dhëna, të cilat nuk u arritën të vërtetoheshin.

- ✓ Institucioni ligjzbatues dërgon informacion se për subjektin e vlerësimit dhe personat e tij të lidhur nuk administrohen informacione ose materiale mbi përfshirjen në aktivitete të kundërligjshme, nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga ndonjë shtet i huaj, nuk ka të dhëna nëse gjatë 10 viteve të fundit i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s apo nëse është kërkuar azil politik në ndonjë shtet të huaj.
- ✓ Institucioni ligjzbatues dërgon informacion se për subjektin e vlerësimit nuk disponon të dhëna.
- ✓ Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), informon se për subjektin e vlerësimit nuk ka nxjerrë urdhër ndalimi, nuk ka kërkuar masa të sigurimit personal (masa shtrënguese/ masa ndaluese, sipas përcaktimeve të nenit 227 të Kodit të Procedurës Penale) dhe vlerësimi i tyre nga Gjykata, nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo person nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale sipas përcaktimit të nenit 278 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka pasur raste të urdhërave ndërkombëtarë të ndalimit.
- ✓ Institucioni ligjzbatues për subjektin e vlerësimit informon me shkresën kthim përgjigje nr. ** datë 18.09.2024, se ka informacion për subjektin, por pas punës verifikuese të këtij institucioni, informacioni është vecuar për asgjësim, pasi nuk është i vërtetuar.
- ✓ AIDSSH-ja për subjektin e vlerësimit bën me dije se nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991.

9. Testimi për përdorim lëndësh narkotike

9.1 Në zbatim të Nenit 38, pika 2 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit dhe deklarimeve personale, subjekti i vlerësimit ka kryer testin për përdorim lëndësh narkotike.

9.2 Në përfundim të testit, sipas ekzaminimit toksikologjiko-ligjor nr. **, datë 14.05.2024 të ardhur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, me shkresë nr. ** prot., datë 14.05.2024, jemi bërë me dije se:

“Në mostrën e marrë subjektit nuk u zbulua prania e produkteve të lëndëve narkotike të grupit të MOP(opiate/heroinë), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (trciklike antidepressante), AMP (amphetamine), MDMA (ekstazi), MET (metamfetamina), BZO (benzodiazepine).

- ✓ *Në konkluzion për vlerësimin e figurës, në përputhje me pikën 3 të nenit 42 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*

a) punonjësi nuk ka kryer deklarin të rremë;

- b) nuk ka informacione, të dhëna të vërtetuara nga agjencitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;*
- c) nuk ka informacion në deklarinë e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

C- VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit; respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në zbatim të ligjit të vlerësimit nr.12/2018, i ndryshuar si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimit në nenin 43 të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
2. Analiza ligjore e vlerësimit të aftësive profesionale e kryer nga Trupa Vlerësuese është mbështetur në:
 - a) të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - b) të dhënat e mbledhura në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 6, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - c) raporti i hollësishëm dhe i arsyetuar i strukturës përgjegjëse pranë DPPSH-së sipas përcaktimeve të Nenit 46, pika 2 e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
3. Trupa përdor si burime për vlerësimin e aftësive profesionale, elementet vlerësuese të përcaktuara në nenin 45, pika 2 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
4. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit mban në konsideratë dhe merr në shqyrtim edhe nëse ka denoncime nga publiku për sjellje jo profesionale të punonjësit, apo informacione të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë joetike.
5. **Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale:**
 - 5.1 Subjekti i vlerësimit, ka dorëzuar në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit ku punon formularin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.

5.2 Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën bazuar në përcaktimet e Nenit 44 pika 2 dhe 3 e tij ².

5.3 Subjekti i vlerësimit kalimtar në momentin e dorëzimit të dokumentacionit ka ushtruar detyrën e Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës.

6. Niveli i arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, të subjektit të vlerësimit:

6.1 Subjekti i vlerësimit sipas të dhënave të administruara ka përfunduar arsimin e lartë dhe është diplomuar:

- **Akademia e Policisë “Arben Zylyftari”, Tiranë, Diploma nr. 786, datë 25.07.2002.**
- **Universiteti “Kristal”, Tiranë, DNP(Drejtësi) nr.651, datë 21.10.2008.**
- **Universiteti “Kristal”, Tiranë, Diplomë MSH, (E drejtë Penale), nr. 173, datë 29.06.2011.**
- **Universiteti “Fan. S. Noli”, Korçë, DNP(Financë-Kontabilitet), nr. FKBK-17, datë 16.07.2012.**

6.2 Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit në vite, Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, bazuar dhe në kriteret dhe kërkesat e vecanta të pozicioneve të punës për funksionet përkatëse që ka mbajtur subjekti për periudhën e përcaktuar në pikat 2 e 3 të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, rezulton se: Subjekti i vlerësimit ka qenë në përmbushje dhe përputhje të kriterit të nivelit arsimor për funksionet që ka ushtruar, si dhe me gradat policore që ka mbajtur si punonjës i Policisë së Shtetit.

6.3 Vërehet se subjekti për një periudhë kohe gjatë viteve 2009-2012 përveç se duhet të ketë përmbushur detyrat funksionale në punën e tij pranë Policisë së Shtetit, paska kryer dhe frekuentuar njëherazi në të njëjtën kohë edhe dy Universitete, në Tiranë dhe Korçë.

7. Të dhënat për punësimin dhe ecuria në karrierë:

7.1 Neni 45, pika 2, shkronja dh, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.

7.2 Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore e Policisë së Shtetit na ka vënë në dispozicion dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit në të cilën përfshihen akte të ndryshme që i

².Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet. 3. Në rast se punonjësi, në momentin e plotësimit të formularit të vetëvlerësimit profesional, ka më pak se 5 vjet në gradën dhe/ose pozicionin që mban, periudhë vlerësimi konsiderohet e gjithë koha e ushtrimit të detyrës në institucionin përkatës.

përkasin arsimimit, punësimit, ngritjes në detyrë, gradimeve, kualifikimeve, vlerësimeve, etj... të cilat janë marrë në analizë për vlerësimin profesional të subjektit.

7.3 Në formularin e aftësive profesionale plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit rezulton se 5 (pesë) vitet e fundit subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

- **Specialist kundër fallsifikimit të monedhave, në Drejtorinë për Krimet Ekonomike dhe Financiare, pranë DPPSH, për periudhën 01.05.2018 deri në 01.04.2019 - sipas Urdhërit nr. 872, datë 24.04.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**
- **Shef Komisariati i Policisë Shkodër, për periudhën 02.04.2019 deri në 13.10.2019 - sipas Urdhërit nr. 384, datë 01.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**
- **Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, për periudhën 14.10.2019 deri në 12.01.2021 - sipas Urdhërit nr. 384/1, datë 14.10.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**
- **Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit dhe Drejtimit, pranë DPPSH, për periudhën 13.01.2021 deri në 18.10.2021 - sipas Urdhërit nr. 31, datë 12.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**
- **Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, për periudhën 19.10.2021 deri në momentin e dorëzimit të Formularit të Vlerësimit të Aftësive Profesionale - sipas Urdhërit nr. 31/1, datë 18.10.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**

7.4 Sipas Vendimit nr.892, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për Gradat në Policinë e Shtetit”, sipas Tabelës së Funksioneve Korresponduese dhe Kategorizimit për cdo Gradë”, dhe Vendimit nr.531, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Numrit të Përgjithshëm të Personelit të Policisë së Shtetit dhe Përcaktimin e Funksioneve Korresponduese dhe Kategorizimin për Gradat në Policinë e Shtetit”, për funksionet Zëvendës drejtor për hetimin e Krimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë, subjekti duhet të mbante gradën “Drejtues” dhe jo atë të Kryekomisarit.

7.5 Në përputhje të funksionit me gradën sipas legjislacionit në fuqi të sipërcituar, subjekti ka qenë në pozicionet si Specialist në DPPSH dhe Shef Komisariati në Policinë Shkodër, duke mbajtur gradën “Kryekomisar”.

7.6 Megjithatë në rastin e subjektit Lorenc Meta, vlen të përmendim se ai e ka gëzuar gradën “Drejtues” që prej vitit 2012, por në vitin 2013 për shkak të ndryshimeve strukturore, ai ka

hequr dorë dhe është ulur nga grada me kërkesë të tij, nga “Drejtues” në “K/Komisar” dhe në 24.05.2022 ka rifituar gradën “Drejtues”, pra në një farë mënyre ai “de facto” e ka gëzuar të drejtën e gradës “Drejtues” edhe pse “de juro” ishte e pamundur.

7.7 Aktualisht që prej 24.05.2022, subjekti mban gradën “Drejtues” dhe emërimi dhe ushtrimi i funksionit që ai mban, është në përputhje të plotë me Vendimin nr.531, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Numrit të Përgjithshëm të Personelit të Policisë së Shtetit dhe Përcaktimin e Funksioneve Korresponduese dhe Kategorizimin për Gradat në Policinë e Shtetit”.

7.8 Nga aktet e dosjes së personelit, rezulton se subjekti i vlerësimit deri në momentin e deklaramit (5 vitet e fundit) ka përfituar gradat policore si më poshtë:

➤ **Drejtues:** **Urdhër nr.1247, datë 24.05.2022**

7.9 Subjektit me Urdhërin nr.2073/1, datë 14.11.2012, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, i është dhënë grada “Drejtues”.

7.10 Sipas Urdhërit nr.2176/2, datë 30.10.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë “Për heqje dorë nga grada, transferimin dhe caktimin në detyrë të një punonjësi policie”, subjekti me kërkesën e tij ulet në gradën “Kryekomisar”.

7.11 Sipas Urdhërit nr.1247, datë 24.05.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për dhënien e gradës një punonjësi policie”, subjektit i është dhënë grada “Drejtues”.

7.12 Trupa Vlerësuese konstatoi se përfitimi i gradës Drejtues është kryer sipas dokumentacionit si më poshtë:

- Urdhëri nr.1026, datë 10.11.2021, “Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurim për fitimin e gradës “Drejtues i Parë” dhe “Drejtues”.
- Vendimi nr.2814/14 datë 22.04.2022 të Komisionit të Gradimit për vlerësimet e aplikantëve që konkurojnë për fitimin e gradës “Drejtues”.
- Urdhëri nr.408/1, datë 05.05.2022 të Drejtorit të Policisë së Shtetit “Për miratimin e listës emërore të së drejtës për gradë të aplikantëve fitues”.
- Vendimi nr.1/1, datë 19.05.2022, të Komisionit për Vlerësimin e Programeve të Shkollimit/Trajnimit të Aplikantëve për marrjen e gradës “Drejtues”, në Akademinë e Sigurisë.
- Urdhëri nr.1247, datë 24.05.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, ku subjekti ka marrë gradën “Drejtues”.

7.13 Në përfundim të verifikimit, rezulton se grada është përfituar në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

8. Vlerësimet e punës:

- 8.1 Neni 45, pika 2, shkronja ç, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe vlerësimet e punës.
- 8.2 Nga aktet e depozituara pranë Trupës Vlerësuese dhe sipas Raportit të Vlerësimit të Aftësive Profesionale të DPPSH-së, rezulton se për periudhat 2021, 2022 nuk ka vlerësime pune të administruara në dosje për subjektin.
- 8.3 Sipas deklarimit të subjektit në formularin e aftësive profesionale për vitin 2021 është vlerësuar “shumë mirë” me 27 pikë nga 28 pikë maksimalja dhe për vitin 2022 është vlerësuar “shumë mirë” me 98 pikë nga 100 pikë maksimalja.
- 8.4 Gjithashtu me Urdhër të Ministrit të Brendshëm nr.620, datë 11.12.2019, i është dhënë “Medalja e Nderit” me motivacionin “Për merita dhe shërbime të vecanta në luftën ndaj krimit dhe sigurimit të rendit e të qetësisë publike, në shërbim të Policisë së Shtetit”.
- 8.5 Për vitin 2018, rezulton me vlerësimin “shumë mirë” (28 pikë në total) për të gjithë treguesit si: integriteti, profesionalizmi, komunikimi efektiv, qëndrimi konstruktiv, paanshmëria, puna në grup dhe organizimi i punës.
- 8.6 Për vitin 2019, rezulton me vlerësimin “shumë mirë”, me 27 pikë (28 pikë në total).
- 8.7 Institucioni i Avokatit të Popullit, me shkresë ka konfirmuar se nuk ka pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin.
- 8.8 Pranë AMP-së, nuk kanë ardhur denoncime/ankesa nga publiku për subjektin për sjellje joprofesionale dhe joetike, gjatë ushtrimit të detyrës të tij sipas parashikimit ligjor të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

9. Përbushja e detyrave të kryera

- 9.1 Neni 43, i Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, përcakton se objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe përbushja e detyrave nga punonjësi, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës që rregullon veprimtarinë e punonjësit.
- 9.2 Neni 45, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: aftësitë profesionale të punonjësit vlerësohen duke u bazuar dhe në përshkrimet e punës për cdo funksion.
- 9.3 Nga verifikimi rezulton se subjekti ka kryer dhe ka përbushur detyrat në përputhje me përshkrimet e punës për cdo funksion.

10. Respektimi i rregullave të etikës/masat disiplinore:

- 10.1 Neni 43, i Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, përcakton se objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe respektimi i rregullave të etikës.
- 10.2 Nga verifikimi dosjes së personelit dhe sistemit RMIS, rezultoi se ndaj subjektit të vlerësimit nuk ka masa disiplinore në fuqi apo të parashkruara për shkelje të rregullave të etikës, sipas përcaktimeve të nenit 43 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

11. Kualifikimet dhe trajnimet:

- 11.1 Nga verifikimi dosjes së personelit të subjektit si dhe verifikimit të pikës 3 të pjesës 3 të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, rezulton se është pajisur me çertifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime të ndryshme gjatë gjithë periudhës së punësimit të tij.
- 11.2 Megjithëse trajnimet e kryera nga subjekti nuk janë në periudhën sipas përcaktimeve të Nenit 44 pika 2 dhe 3 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ato gjithsesi janë të lidhura me thellimin e njohurive, shtimin e vlerave dhe rritjen e performancës në ushtrimin e profesionit të profilit të tij.
- 11.3 Gjithashtu konstatohet se: Trajnime dhe pajisja me çertifikata trajnime janë të lidhura dhe në përputhje me objektin e ushtrimit të funksioneve të tij në detyra të ndryshme ku ka punuar.

12. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshop-e, botime brenda ose jashtë vendit.

- 12.1 Duke ju referuar pikës 5 të pjesës 3 të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, ai ka deklaruar se është angazhuar si vijon:
- Përfaqësuar Policinë e Shtetit, në takimin e 17-të, të Task-Forcës kundër mashtrimeve dhe kontrabandës së cigareve të zhvilluar me datë 09.11.2017, në Bukuresht-Rumani, organizuar nga SELEC HQ.
 - Marrë pjesë në workshop-in me temë, “Lufta kundër korrupsionit gjyqësor dhe politik”, organizuar nga Zyra Tejoqeanike e Zhvillimit, Ndihmës dhe Trajnimit të Prokurorisë, organizuar nga datat 25-28 Shtator 2012, në Hotel Vlora International, Vlorë.
 - Marrë pjesë në workshop-in me temë “Antikorrupsioni në Shqipëri”, organizuar nga Projekti Kundër Korrupsionit në Shqipëri, zhvilluar në Pogradec, në datat 25-30 Prill 2011.
 - Marrë pjesë në workshop-in me temë “Pronësia intelektuale dhe njëkohësisht për organizimin e operacionit “Mërkuri i Bardhë”.

- Marrë pjesë në workshop-in, mbi të drejtat e pronësisë intelektuale, organizuar në Bukuresht, në datat 20-23.03.2017, organizuar nga Departamenti i Sigurisë Kombëtare të SH.B.A.
- Marrë pjesë në workshop-in me temë “Skemat e mashtrimit me TVSH-në”, me Urdher të DPPSH, nr. 1/600 datë 05.04.2018.
- Marrë pjesë në workshopin me temë “Pastrimi i parave, identifikimi dhe sekuestrimi i aseteve kriminale, me origjinë nga trafiku i tokës, korrupsioni dhe financimi i terrorizmit”, me Urdhër të DPPSH nr. 1/688 datë 15.05.2017.
- Marrë pjesë në “12-th Euro South-East Conference”, nga datat 17-21.10.2016, për mbrojtjen e monedhës EURO, në Zagreb, Croatia.

(Pjesëmarrjet në konferenca shkencore, nuk administrohen në dosjen e personelit pasi nuk janë pjesë e saj)

- ✓ *Në konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1 të nenit 47 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*
 - a) *është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;*
 - b) *ka vlerësime pozitive pune;*
 - c) *ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.*

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit Z. **Lorenc Meta**, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2, të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, Z. Lorenc Lulzim Meta, me funksion Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve, nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë **21.11.2024**.

TRUPA E VLERËSIMIT

Henri Naqellari
Kryesues

Loreta Hanxhari
Relatore

Bora Vrenjo
Anëtare